


PËRMBAJTJA



4 Intervistë me Behar Selimin



7 Nënë Rabia dhe sozia...



13 tyku ofrohet ngrohtësi për...



33 Tri ditë të paharruara feste



32 A do të jetë viti 2009 fundi i izolimit?

Lajme	2
Sead Ujkani: Kur do të ngopet KEK-u?	3
Intervistë me gjeneralmajor Behar Selimin	4-6
Sulejman Dida: Nënë Rabia dhe sozia e Adem Jasharit	7-8
Avni Avdiu: Prifti i Maqedonisë dhe ministri i Shqipërisë	9-10
Floriqe Ademi: Familja e Haki Klisturicës që dhjetë vjet nëpër shtëpi të huaja	11-12
Mevlud Zejnullahu: Aty ku ofrohet ngrohtësi për njerëzit me shpresa të thyera	13-14
Imer Pantina: Erotika dhe televizioni	15
Përparim Bublaku: E dinë që është haram, por përsëri luajnë	16-17
Bujar Isma: Morali i shoqërisë në Kosovë	17
Faik Miftari: Tre burra të shquar -	18-19
Demir Reshiti: Reflektime ndërkombëtare për Kosovën	20-21
Muhamed J. Kajolli: Çlirimet (pushtimet) e tokave jo myslimane	22-24
Milazim Krasniqi: Kulti i antikës politeiste në vargun e Seferisit	24-25
Mimoza Sinani: Natyra e gjuhëve semite	26-27
Flamur Maloku: Modelet e kërkimit	28
Naile Demiri: Sa lexohet sot libri në Kosovë?	29
Esat Vatovci: Lajme nga kultura	30
Poezi	31
Vitrina e librit	31
Halil Asllani: Nga kush po keqpërdoret gjuha shqipe?	32
Valentina Gara: Tri ditë të paharruara feste	33
Genta Hoxha: Bota po ballafaqohet me mungesën e ujit	34-35
Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Anemia ..	36-37
Alban Bilalli: A do të jetë viti 2009 fundi i izolimit? ..	38-39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 28
19 mars - 19 prill 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Tiranë

24 shkurt 2009

Shqipëria i ofron Kosovës Portin e Shëngjinit

Kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha ka shprehur gatishmërinë e qeverisë së tij që Kosovës t`i akordohet porti i Shëngjinit për të plotësuar nevojat e saj. Këtë gatishmëri kreu i qeverisë shqiptare e ka shprehur gjatë takimit me përfaqësuesit e kabinetit qeveritar të Kosovës, ministrat: Fatmir Limaj, Ministër i Transporteve, Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë, të cilët shoqëroheshin nga ambasadori i Kosovës në Tiranë, Gazmend Pula.



Hagë

24 shkurt 2009

96 vjet burg për pesë serb të akuzuar për krime në Kosovë

Tribunali i Hagës ka shpallur të pafajshëm ish kryetarin e Serbisë Milan Milutinoviçin. Pesë të akuzuarit e tjerë: Nikolla Shainoviç, Dragolub Ojdaniç, Vlladimir Llazareviç, Nebojsa Pavkoviç dhe Sreten Llukiq, që akuzoheshin për zhvendosje, deportim, vrasje dhe përndjekje të shqiptarëve në Kosovë, në gjysmën e parë të vitit 1999, janë dënuar me gjithsej 96 vjet burg.

Nikola Shainoviç u dënua me 22 vjet, gjenerali Dragolub Ojdaniç me 15 vjet, gjenerali Nebojsa Pavkoviç me 22 vjet, Vlladimir Llazareviç me 15 vjet, si dhe Sreten Llukiq u dënua me 22 vjet burg.

Prishtinë

13 mars 2009

Shtetasit e huaj pajisen me letërnjoftime të Kosovës

Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti ka shpërndarë më 13 mars letërnjoftimet e para për shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në Republikën e Kosovës. Deri tani, shtetasit e huaj që kanë dashur të qëndrojnë në Kosovë më shumë se 90 ditë, janë pajisur me letërnjoftime të përkohshme të UNMIK-ut.

Numri më i madh i të huajve që kanë aplikuar për këtë lloj dokumenti kanë qenë nga Shqipëria, Maqedonia dhe Lugina e Preshevës.



Pas paralajmërimeve për shtrenjtimin e energjisë elektrike

Kur do të ngopet KEK-u?

Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK), ka kërkuar ngritje të tarifave të energjisë elektrike për 11 për qind, duke kërkuar njëkohësisht që çmimet për konsumatorët shtëpiakë të rriten më shumë



Sead UJKANI

Gjendja e rëndë socio-ekonomike në vendin tonë vazhdon edhe më tej. Statistikat flasin për përqindje shqetësuese të nivelit të papunësisë dhe varfërisë së skajshme në vend. Mirëpo ajo çka është për t'u preokupuar është fakti se nuk është duke ndodhur asnjë lëvizje pozitive që do t'i kontribuonte përmirësimit të këtyre parametrave, si dhe përmirësimit të situatës socio-ekonomike në vend në tërësi.

Si pasojë e rëndimit të jetës së qytetarëve ekziston rreziku për ndonjë shpërthim eventual të pakontrolluar të situatës në vend, gjë të cilën e kam potencuar edhe në shkrimet e kaluara, e cila, si e tillë, nuk është aspak e nevojshme për situatën në të cilën ndodhet vendi ynë.

Të gjithë kemi njohuri rreth pakos së re fiskale, të aplikuar së fundmi në vendin tonë, përkatësisht ndryshimeve në normat tatimore, nga të cilat më së shumti u debatua për ngritjen e normës së TVSH-së dhe efektin e saj mbi konsumatorin kosovar. Mirëpo, me gjitha rezervat e shprehura dhe kundërshtimet përkatëse, kjo pako u miratua ashtu siç ishte paraparë dhe tanimë pritet të pasohet edhe me një vendim tjetër, pesha e të cilit gjithashtu bie mbi konsumatorin tonë, që është ndryshimi i tarifave të energjisë elektrike.

Një kërkesë e tillë është parashtruar nga Korporata Energjetike e Kosovës me arsyetimin se inkasimet në bazë të çmimeve aktuale nuk i mbulojnë kostot e Korporatës, si dhe nuk sigurojnë hapësirë për ndonjë investim eventual.

Mirëpo, para se të hedhim një vështrim rreth kërkesës përkatëse të bërë së fundmi nga KEK-u, duhet theksuar se

që nga përfundimi i luftës, energjetika ka qenë sektori më i privilegjuar për realizimin e projekteve zhvillimore, në mënyrë që të arrihet deri tek stabilizimi i situatës energjetike në vend dhe ky sektor, si i tillë, gjithashtu është identifikuar si shpenzuesi më i madh i buxhetit të vendit, që me gjithë investimet e kryera fatkeqësisht nuk është avancuar siç është planifikuar dhe ende karakterizohet dhe vuan nga problemet e vjetra.

Për arsyetimin e lartcekur, KEK-u ka kërkuar ngritje të tarifave të energjisë elektrike prej 11 për qind, duke kërkuar njëkohësisht që çmimet për konsumatorët shtëpiakë të rriten më shumë.

ZRRE: Është korrekte të ngrihen të gjitha tarifat me të njëjtën vlerë

Në lidhje me këtë kërkesë të bërë nga KEK-u, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), në deklaratën e fundit të publikuar me rastin e shqyrtimit të tretë tarifor të energjisë elektrike 2009, ka theksuar si vijon: KEK-u ka



që tarifat për grupet e konsumatorëve jo shtëpiakë të rriten me të njëjtën përqindje, por që tarifat për konsumatorë shtëpiakë të rriten me një përqindje më të madhe, ngase këto tarifa janë më larg tarifave që reflektojnë kostot (siç janë kalkuluar nga KEK). KEK-u, po ashtu, propozon që konsumatorët shtëpiakë nuk mund të mbesin në kategorinë e konsumatorëve pa njehsorë (kategorinë 7) për më shumë se 90 ditë. ZRRE propozon që është korrekte të ngrihen të gjitha tarifat me të njëjtën vlerë, ndërkohë që është duke studiuar metodologjinë e propo-

zuar të vlerësimit të tarifave që reflekton kostot të dorëzuar nga KEK-u. ZRRE do të vazhdojë të shqyrtojë metodologjitë e ndryshme të alokimit të kostos dhe mund të bëjë ndryshime në këtë propozim, para se të marrë vendimin për tarifat përfundimtare.

Ndërsa sa i përket shumës së ngritjes së këtyre tarifave, ZRRE propozon që rritja e tarifave të jetë e njëjtë me rritjen e të ardhurave të lejuara të propozuar nga ZRRE (apo në mesatare 2.5% për të gjitha tarifat).

Reagon BSPK-ja

Natyrisht një ndryshim i tillë në tarifat e energjisë nuk është pritur mirë nga ana e qytetarëve të vendit, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike në vend. Në lidhje me këtë ka reaguuar edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, duke theksuar që një ngritje e çmimeve të energjisë elektrike në vend do të rëndonte edhe më tej situatën socio-ekonomike në vendin tonë.

"Një vendim i tillë do të ndikojë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe të punëtorëve të Kosovës, të cilët edhe ashtu po ballafaqohen me një gjendje të rëndë sociale. Me këtë vendim do të dëmtohet rëndë popullata, punëtorët e Kosovës, si dhe ekonomia e Kosovës" – ka thënë Izet Mustafa nga BSPK-ja.

Vendimi final, në lidhje me ndryshimet tarifore në energjinë elektrike të kërkuara, akoma nuk është marrë. Ky vendim pritet të merret pas shqyrtimit të detajizuar, nga ana e ZRRE-së, të kësaj kërkesë të bërë nga KEK-u, jo më larg se fundi i këtij muaji.

Në përgjithësi, pa marrë parasysh vendim final, gjithsesi duke shikuar dhe duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat ekonomikë në vendin tonë, të cilët flasin për gjendje jo të kënaqshme sociale dhe ekonomike, një ngritje e tarifave të energjisë elektrike vlerësohet se do të kontribuojë negativisht në situatën e përgjithshme në vendin tonë. ■

Intervistë me gjeneralmajor Behar Selimin, ndihmësdrejtor i Përgjithshëm për Policinë Kufitare

Besimi i qytetarëve është

- Në bashkëpunim me EULEX-in do ta shtrijmë autoritetin policor edhe në pikat kufitare në veri të Kosovës;
- Policia e Kosovës ka dhënë prova se është kompetente për të qenë autoritet ekzekutiv policor;
- Nuk cenohet integriteti territorial i Kosovës me hyrje-daljet e paautorizuara të zyrtareve të Serbisë;
- Ka mbetur edhe më pak se një kilometër pa u shënuar.

Intervistoi: Demir RESHITI

Gjeneralmajor Behar Selimi është njëri nga udhëheqësit më të lartë në hierarkinë e Policisë së Kosovës. Në fillim të muajit shkurt të këtij viti, nga ana e ministrit të Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, është emëruar ndihmësdrejtor i përgjithshëm për çështje të Policisë Kufitare. Në intervistën ekskluzive për revistën "Paqja", gjeneralmajor Selimi flet për gjendjen organizative të sektorit që ai drejton, për bashkëpunimin me ish-policinë e UNMIK-ut, me KFOR-in dhe EULEX-in, për (mos)shkeljen e integritetit territorial të Kosovës nga ana e zyrtarëve serbë, demarkacionin e vijës kufitare me Maqedoninë, etj.

Në bashkëpunim me EULEX-in do ta shtrijmë autoritetin policor edhe në pikat kufitare në veri të Kosovës

PAQJA: Si paraqitet gjendja organizative në Policinë Kufitare të Kosovës?

SELIMI: Policia Kufitare është njësi organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, e organizuar në nivel qendror, rajonal dhe në nivel të stacioneve të pikave të kalimit të kufirit me funksione të specializuara.

PAQJA: Sa pika të kalimit të kufirit ka aktualisht Kosova dhe a e ushtroni autoritetin policor në të gjitha?

SELIMI: Republika e Kosovës ka 13 pika të përhershme dhe dy të përkohshme. Me përjashtim të pikave 1 dhe 31 në veri të Kosovës, të cilat vazhdojnë



Gjeneralmajor Behar Selimi është i lindur në vitin 1968 në Skenderaj. Shkollimin fillor e ka kryer në vendlindje, të mesmen (akademine policore) në Vushtrri, ndërsa fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës. Ka kryer edhe një varg trajnimesh e specializimesh në vend dhe jashtë vendit (Tiranë, Gjermani, SHBA), si Menaxhimi i Burimeve të Qeverisjes lokale; Programi mbi komunitetet; Lidershipi dhe menaxhimi me institucione policore; Teknologjia dhe Menaxhmenti; Barazia dhe legjislacioni; Kursi i zyrtarëve të NATO-s; Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe siguria, etj. Është ndër kuadrot e para të Shërbimit Policor të Kosovës, i cili falë punës dhe vetëmohimit ka shënuar rezultate të mëdha, gjë për të cilën edhe është avancuar. Fillimisht ishte zyrtar për bashkëpunim me publikun (2001), më pas zyrtar për informim me media i policisë (2002), komandant i divizionit për siguri të policisë (2003), drejtor i departamentit të mbështetjes për policinë (2004-2006), asistent i komisarit për administratë (2006-2007) dhe së fundi ndihmësdrejtor i përgjithshëm për Policinë Kufitare.

Falë rezultateve të punës është avancuar nga nënkolonel (2001) në kolonel (2004) dhe gjeneralmajor (2006).

Gjeneralmajor Behar Selimi është angazhuar, gjithashtu, edhe nëpër komisione të ndryshme me interes të përgjithshëm si: anëtar i Komisionit Shtetëror për Demarkacion; koordinator për barazi gjinore; koordinator ndërlihdës me Trupat Mbrojtëse të Kosovës; anëtar i Komitetit Drejtues të Kosovës për Rishikimin e Sektorit të Sigurisë, etj.

të administrohen nga ndërkombëtares, në të gjitha të tjerat ushtrime autoritetin e plotë policor. Pra, zbatojmë ligjin për menaxhim të integruar dhe kontroll të kufirit të Republikës sonë. Ndërkohë kemi filluar një bashkëpunim ndryshe, më cilësor me misionin e EULEX-it, posaçërisht rreth pikave në veri, përmes të cilit synojmë që administrimi ynë atje të rritet, për t'i administruar plotësisht në një të ardhme të afërme.

PAQJA: Çka do të thotë kjo? Nuk keni pasur bashkëpunim të tillë edhe me policinë e UNMIK-ut më parë?

SELIMI: Jo, pra. Atje policia ndërkombëtare e UNMIK-ut, në nivel

individësh drejtues, as që ka lejuar të informohemi sa ne kemi pasur nevojë, e lëre më të bashkëpunojë me ne. E patën kuptuar me fanatizëm "kompetencën e rezervuar" dhe e patën konsideruar gjasë të mirë për të qenë edhe një kohë në mision. Në të ardhmen do të kuptohet se, në përgjithësi, në Veri të Kosovës, policia ndërkombëtare jo vetëm që ka bashkëjetuar me sistemin paralel të sigurisë atje, por edhe e ka inkurajuar zhvillimin dhe forcimin e tij. Djegia e pikave atje flet shumë. E dinin dhe asgjë nuk bënë. Nuk kërkuan as ndihmën e KFOR-it, madje m'i rrezikuan edhe oficerët shqiptarë, të cilëve vetëm KFOR-i u doli në ndihmë.

re të Kosovës

parakusht i suksesit tonë

Policia e Kosovës ka dhënë prova se është kompetente për të qenë autoritet ekzekutiv policor

PAQJA: Ju besoni se me EULEX-in do të jetë ndryshe?

SELIMI: Padyshim se po. EULEX-i është mision detyrimisht i kërkuar, i cili do të ndihmojë me këshilla dhe raporte monitorimi. Përfundimisht do të ketë mundësi të ndërhyjë dhe drejtpërdrejt dhe të zbatojë vetë ligjin. Nëse ne funksionojmë profesionalisht dhe kemi kurajën e mjaftueshme ta ndiejmë veten partnerë me ta, ata më rrallë do të kenë punë. Në të kundërtën, nëse çdo gjë e presim nga ta dhe profesionalisht i nënshtrohemi servilizmit, madje edhe llojit të servilizmit të pa kërkuar, detyrimisht do të na shfaqen situatat e ngjashme me UNMIK-un. Më lejoni të them edhe diçka: E meta fillestare e EULEX-it, e që mund të ketë konsekuenca në të ardhmen, është numri i konsiderueshëm i ish-pjesëtarëve të UNMIK-ut, të cilët kanë trashëgimi nga një mandat tjetër dhe se vështirë do të sillen si këshilltarë ata që ishin shefa ekzekutivë. Shpresoj që të tillët, sa më parë, të falënderohen për punën që kanë bërë dhe të presin misione të tjera me karakter ekzekutiv. Policia e Kosovës ka nevojë për këshilla



profesionale dhe mbështetje teknike, ndërkohë që ka dhënë prova se është

të nevojshme, në mënyrë që gjatë vitit të ardhshëm të marrim përgjegjësinë edhe për mbikëqyrjen e vijës së gjelbër.



Nuk cenohet integriteti territorial i Kosovës me hyrje-daljet e paautorizuara të zyrtarëve të Serbisë

PAQJA: A po cenohet integriteti territorial me hyrjet e paautorizuara të zyrtarëve të Serbisë në territorin tonë?

SELIMI: Jo, jo. Integriteti territorial, në kuptimin klasik të fjalës, nuk cenohet me hyrje-dalje të këtilla. Integriteti territorial cenohet me njësi ushtarake të huaja, nëse ato do ta pushtonin territorin tonë. Kjo s'ka gjasa as teorike të ndodhë karshi NATO-s – mekanizmit më të fuqishëm që ka bota, e i cili është në mbrojtje të Kosovës. Ndërkohë që nuk është situata e njëjtë me sovranitetin. Ai akoma vazhdon të cenohet jo vetëm në veri, por edhe në brendi të Kosovës. Sidoqoftë, herët a vonë, rendi dhe ligjet tona do ta respektohen, sepse ato janë dhe do të jenë edhe vullnet i atyre që aktualisht nuk i pranojnë. Iu përkujtoj se këto hyrje-dalje nuk do të ndodhin aty ku zbatohet ligji për menaxhim dhe kontroll të kufirit të Republikës së Kosovës, përkatësisht në pikat kufitare ku ne ushtrojmë autoritet të plotë policor.

PAQJA: Në disa sondazhe të zhvilluara del se Policia e Kosovës është një nga

Policia ndërkombëtare ka bashkëjetuar me sistemin paralel të sigurisë në veri...

...Në të ardhmen do të kuptohet se, në përgjithësi, në Veri të Kosovës, policia ndërkombëtare jo vetëm që ka bashkëjetuar me sistemin paralel të sigurisë atje, por edhe e ka inkurajuar zhvillimin dhe forcimin e tij. Djegia e pikave atje flet shumë. E dinin dhe asgjë nuk bënë. Nuk kërkuan as ndihmën e KFOR-it, madje m'i rrezikuan edhe oficerët shqiptarë, të cilëve vetëm KFOR-i u doli në ndihmë.

kompetente për të qenë autoritet ekzekutiv policor, madje e gatshme për integritet policore të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar.

PAQJA: Cili është roli i KFOR-it në mbrojtjen e kufirit?

SELIMI: KFOR-i vazhdon të jetë garantues i paqes dhe stabilitetit në Kosovë, sikundër edhe i integritetit territorial. Ne akoma nuk kemi mandat, e as kapacitete, për të qenë vijë e parë e mbrojtjes së kufirit dhe, së këndejmi, vetëm asistojmë me fare pak personel. Tani, kur përgjegjësia bie mbi institucionet vendore, besoj se do të arrijmë gjatë këtij viti të ndërtojmë kapacitete

Cenohet sovraniteti, por jo integriteti i Kosovës

Integriteti territorial, në kuptimin klasik të fjalës, nuk cenohet me hyrje-daljet e zyrtarëve serbë në Kosovë. Integriteti territorial cenohet me njësi ushtarake të huaja, nëse ato do ta pushtonin territorin tonë... Ndërkohë që situata me sovranitetin nuk është e njëjtë. Ai akoma vazhdon të cenohet jo vetëm në veri, por edhe në brendi të Kosovës. Sidoqoftë, herët a vonë, rendi dhe ligjet tona do ta respektohen, sepse ato janë dhe do të jenë edhe vullneti i atyre që aktualisht nuk i pranojnë.

institucionet që gëzojnë më së shumti besimin e qytetarëve. A mendoni se duhet punuar edhe më tepër për ta përforcuar edhe më tepër këtë besim?

SELIMI: Patjetër se duhet të punohet më shumë dhe në vazhdimësi që të thellohet besimi në ne, i cili është parakusht i suksesit tonë. Në vitet e para të shërbimit tonë, populli kishte besim

emocional tek ne, meqë për herë të parë kishte policë, të cilët, para se gjithash dhe mbi të gjitha, mbrojnë qytetarin, madje edhe nga pushteti po që nevoja. Tani, përditë e më tepër qytetarët kanë besim real në aftësitë dhe përkushtimin tonë për t'i mbrojtur ata dhe për t'i respektuar të drejtat e tyre. Besimi thellohet duke qenë me ta dhe pranë tyre sa herë që ata kanë nevojë. Kjo shprehet më të arrihet me udhëheqjen e parë vendore.

PAQJA: A ka korrupsion brenda Policisë së Kosovës?

SELIMI: Brenda nuk ka. Pra, jo në nivel organizate apo njësisht organizative, ndërkohë që kemi pasur raste individuale policësh të korruptuar në trafik dhe pika të kalimit të kufirit dhe ata janë larguar nga puna, kurse ndaj tyre po zhvillohen procedurat hetuese.

Me lejon t'iu them se korrupsioni mund të bëhet shumë shpejt më i fortë se përkushtimi dhe dinjiteti i policit tonë. Sado që sistemi dhe procedurat e punës janë jashtëzakonisht të avancuara, nëse nuk mbështeten në buxhet solid, atëherë nuk do ta shihni dallimin aktual mes policëve tanë dhe të rajonit.

Ka mbetur edhe më pak se një kilometër pa u shënuar


PAQJA: Ju jeni edhe anëtar i komisionit qeveritar për demarkacionin. Deri në çfarë mase e keni kryer detyrën me të cilën jeni ngarkuar?

SELIMI: Ka mbetur edhe më pak se një kilometër pa u shënuar. Pra, nga disa qindra mijëra hektarë të përfolur e kontestues për një apo arsye tjetër, sidomos për shkak të marrëveshjes jolegjitime, ndonëse detyrimisht legale, të vitit 2001, sot merremi me vetëm disa dhjetëra hektarë, për të cilët do të punojmë bashkërisht me palën maqedonase dhe me banorët që kanë interes pronësor-juridik. Pa vullnetin e tyre, procesi do të ishte pa legjitimitet, prandaj do të jetë në esencën e përmbylljes së këtij procesi edhe për këta pak hektarë që kanë mbetur.

PAQJA: Në fund, cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e revistës PAQJA?

SELIMI: Të vazhdojnë ta ndihmojnë dhe ta besojnë përkushtimin dhe devotshmërinë e policisë sonë. ■





Korespondencë nga Kukësi

Nënë Rabia dhe sozia e Adem Jasharit

Rabia 84 vjeçe, nëna e 15 fëmijëve nga të cilët 8 jetojnë, ndihet shumë e lidhur me Kosovën dhe me ditën e pavarësisë. Nënë Rabia ndihet me fat që ka pasur rastin të ndihmojë çështjen e Kosovës, duke u shërbyer ushtarëve të UÇK-s në vitet 1998-1999. Një nga djemtë e saj (Fidaimi) ngjan aq shumë me kryeheroin Adem Jashari

Sulejman DIDA

Në fshatin Përbreg të Kukësit është e vështirë të gesh një familje që të mos lidhet me farefis apo me kontribut me Kosovën dhe lëvizjen për pavarësi. Rabia 84 vjeçe, nëna e 15 fëmijëve nga të cilët 8 jetojnë, ndihet shumë e lidhur me Kosovën dhe me ditën e pavarësisë. Lidhjet e para u vendosën që në fillim të shekullit të XX-të dhe kishin të bënin me rezistencën kombëtare kundër pushtesit serb. Ndërsa personalisht Rabia ka pasur fatin, siç thotë ajo vetë, të ndihmojë çështjen e Kosovës duke u shërbyer ushtarëve të UÇK-s në vitet 1998-1999. Më poshtë do të shënojmë faktin interesant që një nga djemtë e saj ngjan aq shumë me heroin e famshëm Adem Jasharin, por le të tregojmë në fillim portretin e nënës Rabie dhe si u lidh ajo me UÇK-në.

Nanë e thërrisnin luftëtarët e lirisë

Nënë Rabia veron në bjeshkë çdo vit nga 6 muaj dhe ka një tufë të madhe bagëtish, me të cilat merret vetë personalisht bashkë me një prej djemve. Grigja e saj përbëhet nga 300 dele, 16 lopë, 4 kuaj, 6 qen, qindra pata e rosa dhe pula deti. Një fermë e vërtetë. Në kohët më kritike qindra djem nga Kosova të inkuadruar në radhët e UÇK-s, pas aksioneve kundër ushtrisë serbe,



kalonin në bjeshkë për të rimarrë energji. Bjeshka e Koritnikut, ku verojnë banorët e këtyre fshatrave, ka shënuar vijën ndarëse mes Kosovës dhe Shqipërisë, një vijë keqndjellëse që u vendos nga ndërkombëtarët në vitin 1921 dhe ndodhet pikërisht në majën e Pikëllimës. Duke qenë se tre djem të Rabies qenë lidhur me njësitet e çlirimtarëve, duke i pritur e përcjellë nga Shqipëria në Kosovë, stanet e familjes shërbyen edhe si burim ushqimi për ushtarët e rajonit të Vrrinit të Prizrenit dhe më gjerë. Rabia kujton shërbimin për ta si një detyrim prej nëne dhe ua bën hallall. “Kam gatue bukën për 90 vetë, djem të ri që luftonin me çliru Kosovën, i kam la e i kam qepë, çdo ditë të hanë e therja nga një dele për ta, hallall ua bëj, u kam qepë 5 mijë stema UÇK-je dhe flamurë në xhaketat e tyre...”. Por gruaja fisnike kujton me lot, ndër të tjerë, një çift fare të ri ushtarësh të lirisë që u vranë në



pranverën e 99-tës. “Agim Shala e kishte emnin, erdh te shpia jonë këtu, u ndrrue në tasha të reja dhe më tha, oj nanë, se nanë më thirrnin ushtarët e Kosovës, unë due të marthohem te kjo shtëpi. Ani, i thashë, marthohu. Po nusen? Nusen do ta marr me vete në luftë, tha dhe ashtu bë. Erdhi nusja nga Zvicra, bëmë dasmën dhe pas dy ditësh që të dy shkuan në luftë. Oh, medet për mue sa më dhimbset ai djalë, u vra bashkë me nusen e vet duke luftue për çlirimin e Malishevës...” - thotë gruaja 84 vjeçe dhe dënes duke vërejtur një foto ku ajo ka dalë me ushtarët në bjeshkë në vitin 1998.

Eksodi

Rabia edhe me rastin e eksodit të 99-tës ka pasur një detyrë mjaft të vështirë, pasi shtëpia e saj në Përbreg priti jo pak por plot 70 persona. “27 prej tyre ishin krejt fëmijë të vegjël, tregon një nga djemtë e Rabies. Nana i ka drejtuar të gjitha punët duke vënë në lëvizje krejt shtëpinë në mënyrë që kosovarëve të mos

u mungonte asgjë. U thoshte nuseve, ti do të gatuash, ti tjetra do të lash rrobat, ti do të mjekosh të sëmurët...” - thotë Halili, djali i madh i Rabies, duke shtuar se 4 kuajt dhe dy makinat e familjes ishin vënë plotësisht në dispozicion të njerëzve të dëbuar nga lufta.

Një “sozi” e Adem Jasharit

Një prej djemve të Rabies, Fidaimi, mban flokë të gjatë dhe shumë njerëz i afrohen me kureshtje por edhe admirim, pasi i ngjan aq shumë heroit të Kosovës, Adem Jasharit. Edhe vetë Jasharët në Prekaz e përqafojnë të përllotur, ndërsa vetë Fidaimi i cili në konfigurimin e vet natyral ruan një pamje të ngjashme me heroin, ndiehet në rol dhe siç thotë ai, edhe krenar. Por nga ana tjetër, përtej ngjashmërisë fizike ai ka një lidhje të hershme, gati të shenjtë, me Kosovën. Aty nga mesi i viteve 80 i jepet shpirtërisht idealeve të lëvizjes çlirimtare të Kosovës, ku të parët e tij kishin pasur trojet e vjetra. Në vitin 1981, dy studentët të Universitetit të Prishtinës, të përndjekur nga pushtuesi serb, ikin dhe vijnë e strehohen tek Fidaimi në Përbreg, ku jo vetëm “strehohen”, por edhe rikonfirmuan lidhjet e vjetra patriotike. Babai i Fidaimit kishte mbetur jetim që në barkun e nënës kur serbët kishin masakruar fshatin e tij, në vitin 1913. Ndërsa lidhjet me farefisin e vet në Kosovë u rivendosën e u forcuan në vitin 1998, kur Fidaimi u angazhua me transportin e ushqimeve për UÇK-n, me transportin e njerëzve të

Oj nanë, unë due të marthohem te kjo shtëpi

“Agim Shala e kishte emnin, erdh te shpia jonë këtu, u ndrrue në tasha të reja dhe më tha, oj nanë, se nanë më thirrnin ushtarët e Kosovës, unë due të marthohem te kjo shtëpi. Ani, i thashë, marthohu. Po nusen? Nusen do ta marr me vete në luftë, tha dhe ashtu bë. Erdhi nusja nga Zvicra, bëmë dasmën dhe pas dy ditësh që të dy shkuan në luftë. Oh, medet për mue sa më dhimbset ai djalë, u vra bashkë me nusen e vet duke luftue për çlirimin e Malishevës...” - thotë gruaja 84 vjeçe dhe dënes duke vërejtur një foto ku ajo ka dalë me ushtarët në bjeshkë në vitin 1998.

plagosur nga bjeshkët në qyte, e kështu me radhë, duke u shkrire si një efektive shumë i rëndësishëm i lëvizjes. Ai ka ndërkohë një kujtim jo të zakonit nga dita kur trupat e NATO-s shkelën në Vërmicë, në kufirin që ndante dy pjesët shqiptare, më 13 qershor 1999. Fidaimi ishte i pari që u ngjit në kullën e doganës, ku bashkë me disa shokë të vet e shkulën flamurin jugosllav dhe e dogjën në asfalt, e në vend të tij vendosën flamurin shqiptar. “Provuam ta grisim por ishte si një llastik, shumë i fortë, atëherë dikush kishte me vete një çakmak dhe e dogjëm në asfalt” - kujton Fidaimi. Ngjarja e 13 qershorit është fiksuar në shtypin dhe në agjencitë evropiane të lajmeve, e Fidaimi ruan disa prej gazetave të asaj dite. ■



“Kam gatue bukën për 90 vetë, djem të ri që luftonin me çliru Kosovën, i kam la e i kam qepë, çdo ditë të hanë e therja nga një dele për ta, hallall ua bëj, u kam qepë 5 mijë stema UÇK-je dhe flamurë në xhaketat e tyre...”

Korrespondencë nga Shkupi

Prifti i Maqedonisë dhe ministri i Shqipërisë



Avni AVDIU

Fundmuaji i shkurtit dhe fillim-muaji i marsit e puqin Maqedoninë dhe Shqipërinë me skandale morale që tronditën opinionin publik. Shqiptarja 21 vjeçare M.K, e cila identitetin e saj e fshehte nën emrin maqedonas Marija Kërstevska, bëri marrëdhënie intime me priftin 67 vjeçar. Ajo duke punuar si masazhiste-prostitutë në klubin e masazheve 'Zoka', në lagjen Maxhari të Shkupit, ka arritur ta mashtrojë priftin maqedonas dhe duke ia shfrytëzuar edhe pakujdesinë e ka filmuar aktin (e seksit oral) në telefonin e saj celular. Më pas i ka përdorur filmimet e saj si material komprometues, duke e kërcënuar priftin se nëse nuk i paguan asaj pesë mijë euro, xhirimet do t'i publikonte në internet dhe nëpër të gjitha mediat. I ndodhur përballë këtij shantazhi prifti pranoi të takohet në restorantin 'Galeb' për t'ia dorëzuar të hollat. Masazhistja-prostitutë angazhoi ndihmësin e saj 45 vjeçar, gjithashtu shqiptar, R.D të riemëruar Deni Stojanovski. Gjatë pranimit të parave ishin marrë vesh që ai të priste në veturë si mbrojtës për çdo rast eventual. Mirëpo prifti, para takimit, e kishte denoncuar rastin në polici. Ndonëse prifti i shpëtoi gjobës materiale, ai nuk i shpëtoi dot degradimit moral.

Nga ana tjetër dihet mirëfilli se rasti Pango, i cili u denoncua në emisionin Fiks Fare në Top Channel, bëri bujë të madhe në Shqipëri. Guximi i gazetares ishte për t'u lakmuar, sepse ajo me gjestin e saj shpëtoi dhjetëra viktima të mundshme. Pas disa komenteve e emisioneve të bëra enkas për këtë rast, ligjshmërisht nuk u skandalizua rasti si rast për shkak të komprometimit moral, sepse askush s'mund ta luante rolin e engjëllit ose të

parafrazonte Jezusin, sipas Biblës: 'le ta gjuaj prostitutën ai që nuk ka bërë asnjë mëkat!'. Mirëpo theksi u vendos te një dimension tjetër: 'keqpërdorimi i detyrës, korrupsioni, shfrytëzimi i detyrës për të përfituar leverdi personale, favore të caktuara, në rastin konkret seksuale etj'. Megjithëse nuk mund të anashkalohej edhe konteksti moral i këtyre veprimeve, prapëseprapë marrja në konsideratë e këtij dimensionit ka një domethënie shumë thelbësore për trajtimin e një problemi gjithëpërfshirës në këto hapësira ballkanike. 'Çështja Pango', rikonfirmoi edhe një herë, por kësaj radhe të dokumentuar me anë të filmimit, profilin e politikanit të këtyre hapësirave.

Duke nxjerrë një paralele ndërmjet priftit maqedonas dhe ministrit shqiptar, dekonstruktohen dhe demistifikohen dy personalitete kyçe të jetës publike: kleri dhe politikanin. Të dy u gjendën në të njëjtin grep. Të dy këto personalitete, pa pasur tendenca për të gjeruar raset, proklamojnë dhe trumbetojnë më së shumti moral, premtojnë shumë dhe shiten si më superiorë. Për kategorinë e parë

ishte prononcuar qysh moti Fridrih Niçe në veprën 'Antikrishti'. Për kategorinë e dytë Makiaveli në veprën 'Sundimtari' me sloganin: nëse futet morali në politikë, atëherë nuk do të keni më politikë, se morali është diçka tjetër, e politika krejtësisht diçka ndryshe. Shikuar nga ky këndvështrim, feja dhe politika si dy shtylla bazike të përditshmërisë sonë vazhdojnë të mbesin në duar të pasigurta. Ndonëse ka përjashtime, në këtë rrafsh, prapëseprapë rëndon fakti se ato janë tepër të rralla. Populli gjithnjë e më tepër ndeshet me fenomenin e përsëritjes së rasteve të kësaj natyre. Dhe atij nuk i mbetet gjë tjetër, përpos që në mungesë alternative të humbë besimin tek njëri e t'i varë shpresat te tjetri dhe kështu, në një zinxhir të pambarimtë, të jetojë nën hijen e një sistemi rrënjësisht të korruptuar...

Pango nuk ka vetëm Shqipëria...

Gjithnjë duke qëndruar në linjën e krahasimit, po t'i kthehemi të gjitha vendeve të rajonit, shohim se Pango nuk ka vetëm Shqipëria, por edhe Kosova,





Maqedonia dhe vendet e tjera ballkanike e më gjerë. Dallimi mund të jetë se Pango ka qenë në njëfarë mënyre edhe më i di-jshëm, prandaj pesha e gabimit të tij mori ato përmasa dënimi nga opinion publik.

Po të marrim shembull Maqedoninë, shohim se politikanët dhe partitë politike këtu janë bërë ente punësimi. Ka me dhjetëra argumente për të dëshmuar se tani për tani në Maqedoni nuk të mjaftojnë për punësim as dy-tri fakultete, as nota mesatare e të gjithave me 10, as magistratura, as doktoratura. Tekefundit mund të punësohesh edhe me tetëvjeçare ose me shkollë të mesme, madje edhe në vende kyçe administrative ku kërkohen njohuri të mëdha. S'prish punë...

As mos ta vras mendjen dikush të shkojë tek këta burra të dheut për të kërkuar punë pa pasur gjininë femërore dhe gatishmërinë për ta shitur trupin në këmbim të vendit të punës, pa pasur xhepin plot me të holla për të dhënë mito, pa pasur librezën partiake të partisë në pushtet, pa qenë servilë i pështirë i tyre. Bile-bile s'të ndihmon as fakti se ke qenë luftëtar ose votues i tyre, madje pa dertin se mbi vlera të luftës, dikush që nuk e ka parë as ëndërr luftën, është ngritur në post mbi gjakun dhe sakrificën e shumë dertlinjve të sotshëm. Ky është 'ideali dhe kauza' e tyre patriotike. Mirëpo, realisht, si mund të quhet kjo ndryshe veçse prostitucion politik. E them këtë sepse prostituta

për ta mbajtur shpirtin e shet trupin, ndërsa politikani për ta mbajtur postin e shet dinjitetin dhe karakterin me veprime të pahijshme. Zaten e pat thënë shumë bukur ish-presidenti amerikan Ronald Regan se 'politika mendohet të jetë i dyti më i vjetri profesion'. Partitë shqiptare sërish kanë nisur karvanin e tyre për kërkimin e votave, pa pikë turpi dhe nuk çajnë kokën fare se nuk kanë mbulesë morale për të bërë këtë. Përsëri i kanë filluar premtimet-gënjeshtret e tyre. Rishtazi dalin me slogane të paturpshme kinse do të bëjnë namin. Përgjigjen më të mirë ua dha Brodec, fshat ky që mbi supe provoi barbarinë më të tmerrshme të tyre: dikur nga dikush kërbacin e tani prej dikujt tjetër injorimin. Ata thanë: 'Ne nuk do të votojmë fare'. Është kjo pika kulmore e vetëdijes dhe pjekurisë politike që kanë arritur shqiptarët në Maqedoni, por fatkeqësisht vetëm pjesërisht.

Duke përmbyllur këtë shkrim që tërhoqi paralelizëm, dua ta përfundoj me një rekomandim. Kushdo që do të votojë, para se ta hedhë votën e tij, le të mendojë thellë e mirë, se mund ta ngrejë në maje të politikës ndonjë Pango tjetër, që s'është e thënë të filmohet, që mund t'i shmanget kamerës investigative, por që veprimet mund t'i ketë edhe më të këqija. Kjo le të vlejë veçmas tani në vigjilje të zgjedhjeve presidenciale dhe lokale në Maqedoni. ■



Shqiptarët e dëbuar nga pjesa veriore e Mitrovicës ende nën mëshirën e fatit

Familja e Haki Klisuricës që dhjetë vjet nëpër shtëpi të huaja

“Më vështirë po e kemi gjatë dimrit. Shtëpia e vjetër vështirë se ngrohet ndonjëherë si duhet. Kur është kohë shumë e ftoftë ngrihen edhe perdet që janë ngjitur” - thotë kryefamiljarja Nazlija.



Florije ADEMI

Familja gjashtë anëtarëshe e Haki Klisurices, tash dhjetë vite jeton në një shtëpi të vjetër me dy dhoma të vogla, në Mitrovicë. Ata vijnë nga veriu i Mitrovicës, ku kanë banesën e cila për këto vite shfrytëzohet, pa asnjë cent, nga serbët sikurse edhe shumë prona të tjera të shqiptarëve.

Për çdo vit, zyrtarë të Habitat-it, tani me emrin Agjencioni Kosovar për Prona, kanë kërkuar nga familja Klisurica që ta lirojnë këtë objekt banimi, por, pas ankesës së kryefamiljarit në pamundësi për të bërë zgjidhje tjetër të strehimit, ata nuk kanë bërë presion.

Më vështirë gjatë dimrit

Kjo familje ka qenë pak me “fat” sepse objekti ku banojnë është shumë i

vjetër dhe falë kësaj vazhdojnë të qëndrojnë aty, pasi askush nuk është interesuar ta blejë këtë pronë, e cila është në shitje kaheerë.

“Më vështirë po e kemi gjatë dimrit. Shtëpia e vjetër vështirë se ngrohet ndonjëherë si duhet. Kur është kohë shumë e ftoftë ngrihen edhe perdet që janë ngjitur” - thotë kryefamiljarja Nazlija.

Përveç objektit jo të përshtatshëm për banim, kjo familje jeton në një gjendje të rëndë ekonomike. Kryefamil-

jari Hakiu ushtron zanatin e këpucëtarit sa për të siguruar kafshatën e gojës, ndërkohë që tre fëmijët janë në shkollë dhe kanë nevojat e tyre për t’u shkolluar si duhet.

Gjendjen e tyre e vështirëson edhe më shumë fakti që dy nga gjashtë anëtarët e familjes janë me aftësi të kufizuara.

E ëma e Hakiut, Maliqja qe pesë vite është e paralizuar. Pensioni i pleqërisë që merr, nuk i del as për barna.

“Moj bijë ato pare s’më dalin as për



Familja Klisurica rrëfen për jetën e vështirë



Në frigorifer, më shumë barna sesa gjëra ushqimore

barna”, - thotë lokja Maliqe, derisa tregon një çantë të mbushur me lloj-lloj barna që e mban afër vetes.

Në anën tjetër Violeta 16 vjeçare tregon brengën e saj, që sytë nuk i ka mirë dhe nuk ka para që të operohet. “Edhe për këmbë që s’muj me ec pa më kap dikush përkrahi, më kanë thanë me u ba operacion po s’kemi pare” –shprehet ajo.

E ëma Nazlija tregon se të afërmit e saj i ndihmojnë zakonisht me veshmbathje për fëmijë, por nuk kanë mundësi për më shumë. “Edhe burri kaniherë ka punë kapak, kaniherë s’ka hiq, edhe ato pare që i fiton më shumë na shkojnë për barna, sesa për nevoja të tjera elementare për jetë” - thotë ajo derisa hap frigoriferin në të cilin më shumë ka barna sesa gjëra ushqimore.

“Qe dhjetë vjet po bahen që jemi tu banu këtu dhe në këto kushte shumë të vështira, kurrë s’ka ardh kush prej komune as me na vizitu se për me ndihmu hiq se hiq. Inshall-llah Zoti na ndihmon e bahet diçka ma mirë edhe për neve” - shprehet zonja Nazlija.

Fat, pothuajse të njëjtë me familjen Klisurisa, ndajnë edhe shumë familje të tjera të dëbuara nga pronat e tyre në veriun e Mitrovicës.

Në mesin e tyre edhe familja e Nezir Hasanit. Kjo familje banon në një oborr me familjen Klisurica. Bashkëshortja e Nezirrit, Elhemja, e cila ndodhej në shtëpi në kohën kur ne e vizituam, tregon se për këto dhjetë vite ka ndërruar disa vendqëndrime.

“Kemi jetu me qira në objekte në lagje të ndry-



Loke Maliqja tregon çantën me barna


shme të këtij qyteti, duke shpresu se një ditë do të mund të kthehemi në banesën tonë, por ja që shkun kaç vite dhe nuk u ndërmorr asgjë në këtë drejtim” - shprehet zonja Hasani.

Jashari: Kemi kërkuar krijimin e një fondi të veçantë për pagesën e qirasë banorëve të veriut që aktualisht jetojnë në anën tjetër të qytetit

Në anën tjetër, zyrtari për informim i Komunës së Mitrovicës, Ahmet Jashari, thotë se gjatë një viti të qeverisjes së re lokale të udhëhequr nga PDK-ja, i është kushtuar interesim i madh rindërtimeve në veri të qytetit, me ç’rast komuna ka investuar mbi 200 mijë euro nga buxheti i saj, ku për tetë vite nuk ishte investuar asnjë cent.

“Gjatë kësaj kohe janë rindërtuar 8 shtëpi në “Lagjen e doktorëve” e cila ka qenë e shkatërruar në tërësi. Në përgjithësi, me ndihmën e qeverisë, në atë pjesë të qytetit janë investuar mbi 4 milion euro për infrastrukturë”.

Jashari pohon se Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Mitrovicë i ka dërguar për këtë vit një shkresë Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar krijimin e një fondi të veçantë për pagesën e qirasë banorëve të veriut që aktualisht jetojnë në anën tjetër të qytetit, për çka ka sinjale pozitive. Po ashtu, sipas tij, për këtë vit, Komuna ka ndarë shumën prej 300 mijë euro për rindërtimin edhe të disa shtëpive në veri të Mitrovicës duke u mundësuar banorëve të kthehen në pronat e tyre. ■





Reportazh nga shtëpia për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare

Aty ku ofrohet ngrohtësi për njerëzit me shpresa të thyera



Mevlude ZEJNULLAHU

Në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë funksionon shtëpia e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, në të cilën momentalisht janë të strehuar 112 persona (63 femra dhe 49 meshkuj) të përkatësive të ndryshme kombëtare. Më së shumti ka shqiptarë -84, (30 femra dhe 54 meshkuj), serbë -12 (10 femra e 2 meshkuj) dhe në numër më të vogël pjesëtarë të nacionalitetit kroat, rom, hungarez, ashkali, rumun e turk.

Në kuadër të kësaj shtëpie funksionojnë edhe përfaqësitë në Skenderaj dhe në Gurakocv, të cilat janë hapur gjatë vitit 2008.

Aliçkaj: Shtëpia ka bashkëpunim të mirë me qendrat për punë sociale nëpër komuna

Në hyrje të ndërtesës shtrihet një oborr i madh dhe përveç një pastërtie

që bije menjëherë në sy, ajo që gjithsesi të le përshtypje është edhe një qetësi që të përcjell gjatë qëndrimit në këtë vend.

Drejtoresha e shtëpisë për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare në Prishtinë, Raze Aliçkaj, tregon se si janë procedurat për t`u pranuar në shtëpinë e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare. "Për t`u vendosur në këtë shtëpi, personi duhet të jetë banor i përhershëm i Kosovës, moshë mbi 65 vjeçare, kurse kriter vendimtar është të mos ketë përkujdesje familjare. Personi, i cili vjen në këtë institucion,

duhet të ketë certifikatë nga psikiatri që nuk ka sëmundje psikike, e po ashtu edhe certifikatë nga dermatologu që nuk ka ndonjë sëmundje infektive" – thekson drejtoresha Aliçkaj, duke shtuar se kjo shtëpi ka bashkëpunim të mirë me qendrat për punë sociale nëpër komuna. "Qendrat nëpër komuna e kompletojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe në institucionin tonë është komisioni i cili e shqyrton kërkesën, ndërsa vendimin përfundimtar për vendosjen e tyre në institucionin tonë e jep drejtori i departamentit të mirëqenies sociale" – shpjegon Aliçkaj.





Petkana Llomigora: Kam shoqe këtu dhe nuk e ndiej mungesën e askujt

Duke ecur nëpër korridoret e kësaj ndërtese takojmë shumë persona të moshuar, të cilëve pleqëria nuk u ka ofruar më shumë se kaq. Përveç që të bisedojnë mes vete dhe me stafin punues, ata kënaqen kur ndonjë i "panjohur" shkon dhe i takon. Gjatë gjithë vizitës sonë, ata na buzëqeshin dhe shprehin dëshirën e madhe që ne të ndalemi dhe të bisedojmë me ta.

E ulur në sallën e ndenjes qëndronte Petkana Llomigora 65 vjeçare, nga Zubin Potoku, e cila në këtë shtëpi jeton që 15 vite. Ajo shprehet se tanimë është mësuar të jetojë këtu dhe është shumë e kënaqur me kushtet. Ajo i falënderohet stafit punues për përkujdesjen që tregojnë vazhdimisht ndaj saj. "Unë thujse prej që e mbaj veten mend jam me këta njerëz, janë familje për mua, po ashtu kam shoqe këtu dhe nuk e ndiej mungesën e askujt më" – shprehet Petkana.

Ditët e pleqërisë këtu i kalon edhe çifti Musa nga Gjilani

Në katin e dytë të ndërtesës ndodhet dhoma e çiftit bashkëshortor Hajredin Musa 80 vjeçar dhe Hasime Musa 73 vjeçare nga Gjilani, të cilët që nga tetori i vitit të kaluar jetojnë në këtë shtëpi.

Duke rrëfyer për jetën e tyre, zonja Hasime tregon se kanë pasur katër fëmijë, të cilët kanë vdekur kur ishin shumë të vegjël. "Çka nuk don Zoti me të dhënë vetë, me zor nuk mundesh me ja marrë. Ne u pajtuam me jetën tonë që të jetojmë në vetmi, por kur pleqëria na mundi dhe nuk kishim shëndet të kujdesemi për veten, erdhëm këtu dhe jemi shumë të kënaqur me kushtet dhe kujdesin që të gjithë e tregojnë për ne".

Hajredini thotë se për ata persona që nuk kanë fëmijë vend më të mirë se ky nuk ka. "Njerëzit që nuk kanë fëmijë janë njerëz pa shpresë. Nuk kanë arsye të gëzohen, nuk kanë se kujt t'ia presin suksesin. Mirëpo, jeta duhet jetuar e ne prej që jemi këtu e kemi një rehati të madhe. Çdo ditë

në mëngjes na viziton mjeku, ushqimin e kemi me rregull, e po ashtu ujë të ngrohët për t' u pastruar kemi pandërprerë".

Duke ecur në korridoret e gjata të ndërtesës, drejtoresha shtrëngonte duart me të gjithë ata të moshuar që na përcillnin me kureshtje të madhe. Ajo tregon se si është mëshiruar me këta njerëz. "Nëse një njeri nuk e merr me shpirt këtë punë dhe nuk e ndien dhembjen së bashku me ta, e po ashtu nuk familjarizohet me hallet e tyre, asnjëherë nuk do të jetë i suksesshëm e mbi të gjitha ata nuk do të ndihen mirë, sepse këtyre ju ka munguar dashuria, buzëqeshja e mbi të gjitha një fjalë e ëmbël" – thekson drejtoresha.

Ky institucion ka shërbim 24 orësh për të gjithë, duke filluar nga ushqimi, veshmbathja, mirëmbajta, terapia e punës, shërbimet shëndetësore, etj.

Ushqimi është i begatshëm dhe jepet sipas diagnozës p.sh. ushqim të veçantë kanë ata që vuajnë nga diabeti, hipertensionin etj.

Gratë merren me punë dore...

Gjatë ditës ata merren me mjaft aktivitete për t' a kaluar kohën e lirë. Njëra ndër këto aktivitete është edhe ajo e terapisë së punës, ku zakonisht gratë punojnë punë dore e pastaj i ekspozojnë dhe presin që t' i sheshin. Punëtorët e kësaj shtëpie thonë se mjafton vetëm pak angazhim dhe dëshirë që të punohet me këto gra, në mënyrë që ato të ndihen të lumtura dhe të qeta.

Ne u larguam nga shtëpia e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, të përcjellë nga përshëndetjet dhe buzëqeshjet e atyre njerëzve që jeta i ka bërë të atillë, sa që i gëzon edhe një fjalë e mirë, një buzëqeshje dhe një shtrëngim dore nga kushdo qoftë. ■



Erotika dhe televizioni

Efektet shoqërore të erotizimit të ekranit, gjithnjë e më shumë, bien në sy në shoqërinë tonë. Nganjëherë, kjo paraqitet si vlerë, e nganjëherë si rrënim i traditës, e nëse e shikojmë nga këndi fetar, si mëkat shumë i madh

Imer PANTINA

Nuk ka asnjëfarë dyshimi se ekranit televiziv sot është një stuhë që njeriun e shoqëron dhe e ndihmon që t'i përshatet më lehtë shoqërisë. Në të mund të gjejmë argëtim, shkencë, arsimim dhe bile është e vështirë të thuhet se cilin aspekt të njohurive të njeriut nuk e prek. Mirëpo, në tërë këtë, si një fatkeqësi breshër që nuk na pyet fare, kanë vërshuar një sërë dukurish të cilat jo gjithëherë janë të ndershme dhe të dobishme.

Efektet shoqërore të erotizimit të ekranit, gjithnjë e më shumë, bien në sy në shoqërinë tonë. Nganjëherë, kjo paraqitet si vlerë, e nganjëherë si rrënim i traditës, e nëse e shikojmë nga këndi fetar, si mëkat shumë i madh. Me një fjalë, erotika është bërë temë diskutimi për shumë arsye, për të cilat, natyrisht, vetëm disa prej tyre ne do t'i shqyrtojmë në këtë punim.

Erotika si dekor biznesi

Para disa kohësh, në programet televizive, të cilat paraqitnin biznesin e lotarisë (Telebingo, Starbingo, etj.) si dekorim kryesor të skenës së shfaqjes rekreative artistike, krahas laserëve reflektues me ngjyra të ndryshme dhe mjeteve të tjera dekoruese, ishin edhe vajzat, të cilat me veshje gjysmëlakuriqe reflektonin erotikë. Pra, reflektonin erotikë pa asnjë funksion tjetër në skenë.

Një dekor i tillë skenik patjetër të shtyn të mendosh për qëllimet e organizatorëve. Ta shohim një mendim lidhur me këtë.

A.P., dizajner i gazetës "Infopress", student i dizajnit dhe njohës edhe i dizajnit skenik, pyetjes se përse insistohet në dekorimin e skenës me trupin fizik të vajzave të bukura, i është përgjigjur me shkrim në këtë formë: "Edhe këtu, ku punoj unë në këtë gazetë, erotika publikohet për ta tërhequr lexuesin. Ndërsa, në skenë, vajzat shërbejnë për ta joshur shikuesin, për ta bërë një spektakël sa

më të dehur dhe esenca kryesore, është, natyrisht, për t'i joshur drejt biznesit të lotarisë. Unë, kategorikisht jam kundër këtij lloji makabër të paraqitjes erotike".

Duke qenë një emision që promovon argëtim të llojit të vet dhe biznes, njëkohësisht, një gjë dihet e sigurt nga pamja e jashtme: Erotika në masë të madhe ka marrë konotacione të reklamimit të biznesit. Kështu, për shembull, një automobil i prodhimit të fundit, zakonisht paraqitet me një poster me një vajzë të bukur, apo një telefon celular, zakonisht reklamohet me trupin gjysmëlakuriq të një vajze. Pra, biznes dhe erotikë bashkë. Por, cili mund të jetë qëllimi? A kemi të drejtë të mendojmë se shoqëria është aq e pasionuar pas shikimit të pamjeve erotike, sa që të themi se nuk mund të zhvillohet një spektakël, apo nuk mund të reklamohet një biznes pa një vajzë gjysmëlakuriqe?! Pra, pa një vajzë që me pamjen e saj shpreh erotikë?! Sigurisht se këto pyetje kërkojnë një thellim brenda strukturës së një shoqërie për të parë se ku qëndron popullarizimi aq i madh i këtyre pamjeve.

Ata që i udhëheqin këto spektakle i kam vërejtur se në masë shumë të madhe i trumbetojnë bukurisë vajzërore. Kështu, gati është e pamundur që në një spektakël të tillë, (fjala është për ato vendore) të mos përfillet për bukurinë e "dekorit". "E bukura e dheut", "Bukurorshet tona", "Vajzat e bukura", "Hijanat" etj. janë vetëm disa nga emërtimet që, në spektakle të tilla, thirren vajzat për t'u reklamuar në skenë. Bile, edhe ndihma e tyre e herëpashërme, ta zëmë në tërheqjen e ndonjë numri të lotarisë, nuk është aspak funksionale. Thjesht, ato nuk ndihmojnë diçka të nevojshme. Ndihma bëhet vetëm si shkas i reklamimit fizik të tyre. Megjithatë, këto spektakle shikohen dhe në televizion zënë vendin qendror. Bile, në ndihmë të kësaj, shpeshherë vihet edhe Ministria e Kulturës, e cila gjer më tani akoma nuk ka bërë asgjë për ruajtjen dhe zbardhjen e trashëgimisë së hershme antike shqiptare.

Në përkrahjen e erotizimit të ekranit ka edhe mekanizma të tjerë që e ndihmojnë në masë të madhe. Kështu, në televizione, bukuria femërore shpeshherë zë vend edhe në prezantime të tjera përveç të spektakleve. Reklammat që bëhen për çdo ditë për humbjen e peshës, për prezantimin e rrobave, përveç biznesit, kanë si qëllim edhe nxitjen e dukjes erotike. Këtë e shprehin shumë qartë, kur thonë, për shembull: "Do të keni një trup shumë seksi". Mandej, reklamimi i shpeshtë i kontraktivëve nuk e jep aspak edukatën e duhur. Pra, nuk preket thelbi i çështjes së mbetjes së shtatzënisë së padëshiruar, që janë marrëdhëniet intime jashtëmartesore, por anashkalohehet imoraliteti për t'i shërbyer qëllimit erotik. Pra, erotika përsëri paraqitet si diçka normale. Shembuj të tillë mund të marrim shumë, mirëpo, nga këto do të nxjerrim një konkluzion. Në gjithë këtë, pra në erotizimin e ekranit, ka një mekanizëm mjaft të fuqishëm që e organizon dhe e fuqizon, edhe përkundër asaj se mund të jetë e pëlqyeshme apo e papëlqyeshme. Ky mekanizëm krijon tek shikuesi iluzione, gjë që është edhe qëllimi i televizionit. Dhe shikimi i shpeshtë, qoftë edhe ai me paragjykim të keq, patjetër se do të ndikojë tek shikuesi. Dhe, kjo mendoj unë, është njëri ndër efektet që erotika ngjall tek ai që e shikon. Pra, shpeshherë njerëzit nuk mund t'i përballojnë një organizimi të tillë që bëhet për ta joshur atë drejt erotikës. Erotika shërben çdo kund si dekor dhe funksioni i vetëm i saj, në të shumtën e rasteve, është joshja seksuale. Pra, këtu kemi një përzierje ndjenjore, ngase paraqitet një bukurie për ta fshehur një qëllim më pas. Dhe, kështu, nga një joshje e tillë të hyhet në joshjen tjetër, që është informimi me artikullin që e reklamon biznesi. ■

(Autori është profesor në Shkollën e Mesme "Fehmi Agani" në Klinë, master i Gazetarisë dhe Komunikimeve Mediale.)

Bastoret sportive një dukuri shumë e përhapur në Kosovë

E dinë që është haram, por për

Sabri ef. Bajgora, kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, dukurinë e bastoreve sportive, e quan si negative dhe të rrezikshme dhe ka kërkuar nga të gjithë, madje edhe nga qeveria, që të punojnë për parandalimin e kësaj dukurie

Përparim BUBLAKU

Bastoret sportive, në kohët e fundit janë vendet më të frekuentuara nga të rinjtë tanë, të cilët luajnë me shpresë se do të fitojnë para për nevojat e veta, duke mos pasur mundësi që të gjejnë ndonjë vend pune, edhe pse thonë se e dinë që është haram të luajnë.

Ben Velu, student në Fakultetin e Gjuhës Angleze, në Universitetin e Prishtinës, është njëri ndër studentët e shumtë që provon fatin e tij në bastore. Ai e pranon që është haram të luash dhe është ndaluar nga feja. Por ai e justifikon këtë duke u nisur nga fakti se luan me shpresë se do të fitojë dhe t'i mbulojë shpenzimet e veta gjatë studimeve.

“Unë luaj bastore së paku dy herë në javë. E di që është haram që luaj, por luaj me shpresë se do të fitoj dhe t'i mbuloj shpenzimet e mia, që t'ia lehtësoj edhe familjes, sime e cila jeton me një rrogë mësuesi” - thotë ai. Velu, po ashtu, thotë se nuk i ka ndodhur që të humbë më shumë se dy apo tri euro në javë, por thotë që ka fituar deri në 300 euro.

“Hiç më larg se para dy dite i kam fituar 120 euro dhe në këtë tikitë kam shtënë vetëm një euro. Kështu që deri sot nuk më ka ndodhur që të humb më shumë se tri euro” - shprehet Ben Velu.

Mbi 400 tiketa brenda një dite

F. C, i cili punon në njërin nga bastoret e shumta në Kosovë, shprehet i habitur me numrin e madh të të rinjve që luajnë në bastore.

“Jam i habitur me numrin e madh të të rinjve që luajnë në bastore. Ndodh që brenda një dite të luajnë mbi 400 veta. Numri më i madh i tyre janë nxënës të shkollave të mesme dhe atyre të papunëve” - shprehet ai duke shtuar se shumica e atyre që luajnë, kryesisht luajnë me shuma të vogla, por nuk e mohon që ka edhe të atillë që luajnë me shuma të mëdha dhe që kanë fituar mbi 3.000 euro. “Tiketa më e shpeshtë e shtypur është 1euro, por ka edhe të atillë që luajnë edhe me nga 100 euro dhe më kujtohet se shuma më e madhe e fituar këtu është 3.800 euro” - tha F. C.

Bajgora: Qeveria duhet ta ndalojë me ligj punën e bastoreve

Sabri ef. Bajgora, kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, dukurinë e bastoreve sportive e quan si negative dhe të rrezikshme dhe ka kërkuar nga të gjithë, madje edhe nga qeveria, që të punojnë për parandalimin e kësaj dukurie.

“Është e qartë, se në kriza të tilla balafaqohen vendet në tranzicion por, në Kosovë, një gjë e tillë ka marrë përmasa shqetësuese dhe alarmante.

“Ne të gjithë, duke filluar nga qeveria dhe të gjitha institucionet e tjera relevante, duhet të bëjmë përpjekje serioze për ta ndaluar këtë gllabërim të rinisë sonë, nga ana e të ashtuquajturave bastore sportive” - ka thënë Bajgora.

Ndërkaq sa i përket qëndrimit së Islamit ndaj lojërave të fatit, ky qëndrim është i qartë: ato janë të ndaluara. “Qëndrimi i Islamit sa i përket lojërave të fatit, bixhozit (kumarit) e tash edhe bastoreve është i qartë dhe shumë eksplicit. Që të gjitha janë haram, gjëra të ndaluara e të urryera” - thekson kryemami Bajgora, duke shtuar se “lojërat, qëllimi i të cilave është

BASTORE SPORTIVE
KOSOVA-BAST




BASTORE SPORTIVE
KOSOVA-BAST

sëri luajnë

të fitohen para në mënyrë të pandershme, duke humbur kohën e lirë e me argëtim të padobishëm janë në kundërshtim të plotë me natyrën njerëzore dhe, si të tilla, Kur'ani i ka ndaluar rreptësisht. I Lartmadhërishtmi në Kuran, në suren EL BEKARE-188, ka thënë: 'Mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të pandershme...'

Sabri ef. Bajgora ka treguar edhe pasojat e personave të cilët luajnë bastore sportive. "Në fillim, ata ndihen të lumtur dhe mendojnë se po fitojnë para pa kurrfarë mundimi, por efektet e kësaj loje ndihen më vonë. Me kalimin e kohës tek bastorxhinjtë vërejmë ndryshime drastike, luhatje emocionale, nevroksoje për shkak të humbjeve dhe, në fund, depresion dhe humbje të vullnetit për jetë. Ky është ndikimi i shejtanit i cili ia zbukuron njeriut veprat e shëmtuara, prandaj edhe për këtë arsye Allahu xh. sh. në Kur'anin famëlartë thotë: "O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar (El-Maide, 90)". Rrugëdaljen nga kjo dukuri për rininë, Bajgora e sheh në angazhimin e përbashkët të Qeverisë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe të gjithë njerëzve të vullnetit të mirë.

"Rrugëdalja e vetme sipas meje, është që qeveria ta ndalojë me ligj punën e këtyre bastoreve, shumica e të cilave janë të palicencuara dhe, në vend të tyre, rinisë sonë t'i ofrojë programe sociale dhe kulturore, ku ata do të angazhoheshin në projekte të ndryshme bamirësie, e pse jo edhe të ndonjë përfitimi material, të holla me të cilat do të arrinin të shkolloheshin e të shpëtonin nga këto paudhësi. Në anën tjetër, edhe Bashkësia Islame e Kosovës dhe të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë do të duhej të mbanin ligjërata javore nëpër xhami, nëpër klube, biblioteka dhe shkolla fillore e të mesme, për t'ua tërhequr vërejtjen shkollarëve tanë, se mësimi është gjëja primare për ta, nëse dëshirojmë një rini të shëndoshë, e cila nesër do të jetë e gatshme të ballafaqohet me sfidat e jetës dhe me qeverisjen e shëndoshë të vendit tonë" - ka përfunduar Sabri ef. Bajgora. ■



Morali i shoqërisë në Kosovë

Bujar ISMA

Ndonëse jetojmë në një vend demokratik, të moderuar dhe evropian, elementet negative që e kanë kapluar shoqërinë kosovare vërehen në masë të madhe. Pa dyshim që morali jo i mirë është njëri nga këto cilësi të shumta të shoqërisë sonë.

Si shkaktarët kryesorë që ndikojnë në prishjen e moralit të shoqërisë sonë janë: ndikimi i kulturave të huaja, paraja, emancipimi, korrupsioni etj. Kosova, deri në përfundim të shekullit të XX-të, ishte e kufizuar dhe e shkëputur nga bota moderne, për shkak të regjimit të atëhershëm. Me kalimin e këtij regjimi dhe fillimi i tranzicionit, vendit tonë iu hapën të gjitha rrugët drejt kulturave evropiane. Populli ynë, i etur pas gjërave evropiane, filloi të thithte çdo gjë që i vinte, duke mos shikuar se a është e dëmshme apo e dobishme. Në kuadër të këtij tranzicioni, elementet negative kanë zënë vend të madh, duke filluar nga prostitucioni, droga, bixhozi, alkooli, korrupsioni, e deri te mosrespektimi i prindërve, gjë e cila ka qenë shumë e çmuar tek ne.

Emancipimi është pjesë e rezultatit të ri, i cili ka zënë vend të dukshëm në sho-

qërinë tonë. Kuptimi i tij i pastër shpeshherë është keqkuptuar nga njerëzit. Në emër të emancipimit, njerëzit, në të shumtën e rasteve, morën tatëpjetën që ndikoi drejtpërdrejt në prishjen e moralit të shoqërisë. Njerëzit duke menduar se janë duke u emancipuar filluan të përdorin drogën, alkoolin dhe gjëra të tjera negative, që nuk kanë të bëjnë aspak me kuptimin real të tij.

Paraja, që është element bazë për mbijetesë, ua shtoi njerëzve interesin pas saj, duke shkelur të gjitha normat morale për të arritur tek ajo. Edhe pse mënyra më e mirë për ta fituar atë është ndershmëria, jo të gjithë e respektojnë këtë cilësi të pastër njerëzore. Korrupsioni është i theksuar më së shumti në të gjitha nivelet dhe, pa dyshim, që korrupsioni nuk vjen nga morali i mirë.

Edhe pse dukuritë e cekura ishin të pranishme edhe më herët në vendin tonë, ato ishin në një masë tepër të vogël dhe të kufizuar, tek një pjesë e kufizuar e shoqërisë. Përmasat që këto kanë filluar të marrin tani janë tepër shqetësuese, duke mos harruar asnjë kategori shoqërore. Morali, që është katalizatori kryesor i vlerave shoqërore, duhet të fortifikohet dhe të mbahet larg gjërave që ndikojnë në prishjen e tij, e jo t'i ekspozohet çdo gjëje që i del përpara. ■

Tre burra të shquar – që më kanë

Riza Gashi nga Mitrovica, Hasan Vuçitërna nga Rahoveci dhe Rashid Gorani nga Peja, - tre burra shqiptarë, që janë shembull se si duhet vepruar për çështjet fetare-kombëtare



Faik MIFTARI

Brezi ynë, që ka lindur në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të, e ka për obligim që të shkruajë për personalitetet e çmuara që kanë jetuar dhe vepruar gjatë shekullit të XX-të, ashtu që figurat dhe veprat e tyre të mbesin të shënuara në letër, për të mbetur të paharruar shekuj me rrallë... Gjatë këtij gjysmë shekulli, të kaluar në sistemin komunist, janë anashkaluar dhe lënë anash figurat dhe personalitete të çmuara që kanë lënë gjurmë në shoqërinë tonë dhe kanë dhënë kontribut të çmuar, si në aspektin islam, ashtu edhe në atë kombëtar të popullit tonë. Qëllimi i shkrimit tim është që të shkruhet dhe të shënohet veprimtaria fetare e atdhetare e këtyre personaliteteve, në mënyrë që ata të mos harrohen, siç thotë thënia e njohur e mulla Mustafa Basheskisë: “çdo send që shënohet mbetet, çdo send që mbahet mend, harrohet”.

Në këtë shkrim do të ndalem tek tre burra shqiptarë, që janë shembull se si duhet vepruar për çështjet fetare-kombëtare. Ata burra ishin: Riza Gashi nga Mitrovica, Hasan Vuçitërna nga Rahoveci dhe Rashid Gorani nga Peja. Unë nuk do të ndalem në biografite e tyre, por në kontributet e tyre fetare e kombëtare, që kanë lënë gjurmët dhe kanë ndikuar në mesin e një rrethi më të gjerë shoqëror e fetar në Kosovë.

Riza Gashi - atdhetar me largpamësi të veçantë...

Riza Gashi ka qenë një personalitet i rrallë nga Mitrovica, i cili ka jetuar dhe vepruar në Mitrovicë. Riza Gashi ishte një besimtar dhe atdhetar i vërtetë me një largpamësi të veçantë politike, fetare, kombëtare, kulturore, gjatë periudhës komuniste në të cilin ka jetuar. Njeri që

gjatë gjithë jetës ka lexuar dhe ka poseduar një bibliotekë të rrallë në atë kohë. Ka pasur njohuri të jashtëzakonshme të proceseve aktuale politike, fetare, kombëtare, si në aspektin kombëtar, e sidomos atij ndërkombëtar. Ka mbajtur korrespondencë të rregullt me personalitet e njohura të asaj kohe sikur që ishin Hysein ef. Gjoza nga Sarajeva, Ali ef. Bulaçi nga Stambolli, Tevfik ef. Nahi nga Kajroja (vëllai i myderrizit të njohur nga Gjakova Hasan ef. Nahut, njëri nga përkthyesit e Kur'anit në gjuhën shqipe) e të tjerë. Ky burrë i madh, mua më ka frymëzuar. Ishte njeri me ndikim, ashtu që lirisht mund të them që pas babait tim, që më ka edukuar në frymën islame e shqiptare që nga moshat 7 vjeçare, më Ryzhdi Dapshkronjat hoxhës tim Spahiu shkro- R i z a qenë në torit tim kalitjes aspektin k e n d - të jetës s i m e . mirë i turke, e nga d h e i litislame

turke dhe boshnjake. Ka qenë lexues dhe përcjellës i rregullt i shtypit ditor, javor, mujor e vjetor. Karakterizohej përveç të tjerash edhe nga një kujtesë e fortë. Mbante mend shumë ngjarje nga e kaluara e ndritshme historike e popullit tonë. Pata rast të njoftohem me Riza abejin, pasi që në atë kohë isha në studime në Mitrovicë dhe gjatë kohës së kaluar pesëvjeçare në Mitrovicë, krahas diplomimit tim në fakultet, lirisht mund të them se mora edhe një diplomë të pashkruar, nga mentori im i jetës, vizionit dhe këndvështrimit islam vendor e botëror, të profesorit tim të nderuar Riza abej. Shpesh shkonim bashkë në namazin e xhumasë në xhaminë e Haxhi Veselit dhe pas dëgjimit të hytbes dhe faljes së farzit, dilnim nga xhamia dhe nuk ka qëlluar kurrë që të mos u jepte edhe sadaka fukarenjve në xhami.

Netët e Ramazanit ishin të veçanta, me ç'rast kam përfituar më së shumti nga mësimet, ligjëratat, këshillat e rralla për atë kohë, të cilat, si të tilla, ka qenë e pamundur të mësohesh në xhami apo diku në ndonjë ambient tjetër, pasi që ishte sistemi komunist në fuqi. Herë pas here vetëm ndërhyja me pyetje, për të vazhduar dhe qartësuar më tutje aty ku ka mbetur, e sidomos tema të aspektit aktual politik islam botëror dhe gjendjes së muslimanëve nëpër botë, pasi ishte një kënaqësi e veçantë për



frymëzuar

të dëgjuar. Ishte një njohës i rrallë i situatës aktuale politike islame botërore në atë kohë në Kosovë. Qysh në atë kohë, me endje dhe pasion, lexonte tefsirin e Sejjid Kutbit në shumë vëllime të përkthyer në gjuhën turke. Kur dëshironte të citonte në origjinal ndonjë citat nga ndonjë libër, vetëm më urdhëronte që të ngrihem e të marr librin e caktuar, në raftin e librave, i cili gjendej për shembull në rreshtin e dytë, me radhë i pesëmbëdhjetë, faqja e njëzeteshtatë, pasusi i trembëdhjetë... Me të vërtetë e kishte memorien e fortë dhe të rrallë. Netëve të Ramazanit e dëgjonte rregullisht Radio Kajron, e sidomos me ëndje kishte qejf të dëgjonte këndimin e Kur'anit nga hafizët e shkëlqyer egjiptianë. Në Kosovë, me ëndje, kishte qejf të dëgjonte këndimin e Kur'anit nga mulla Mustafa ef. Dervisholli, për të cilin thoshte se është bilbili i Kosovës dhe se shpirti i tij rehatohej nga zëri i bukur që posedon mulla Mustafa ef. Dervisholli. Për respektin e veçantë që kam pasur ndaj mentorit tim Riza abej, natën që ndërroi jetë për në Ahiret, unë pashë në ëndërr që Riza abej ka vdekur, pasi që në atë kohë gjendesha në Greqi, në ishullin e Kretës, ku shkova si student gjatë dimrit për të punuar përkohësisht në vjeljen e portokajve dhe ullinjve gjatë sezonit dimëror. Ishte shkurti i vitit 1989 kur Riza Gashi ndërroi jetë, inshallah Allahu xh.sh. e shpërblen me xhenetin firdevs. Përherë do të mbetet në kujtim thënia e tij e njohur se "unë nuk do përjetojë daljen e Islamit nga katër muret e xhamisë, i cili në atë kohë ishte prezent gjatë sistemit komunist, por ti me siguri se do ta përjetosh, sepse Islami është edhe jashtë katër mureve të xhamisë".

Hasan Vuçitërna - besimtar e atdhetar vizionar

Personaliteti i dytë i çmuar ishte Hasan Vuçitërna (Haxhi Cana) nga Rahoveci, një burrë, besimtar, atdhetar, vizionar, mik, dost i veçantë, i pandalshëm në ecejakun e rrugës për shpërndarjen e ideve fetare islame dhe kombëtare shqiptare. Ka qenë i dashur dhe i afërt dhe

brengat e tij përherë kanë qenë halli i besimit islam dhe çështja e pazgjidhur shqiptare. Ka qenë prore në lëvizje, duke vizituar miqtë dhe dashamirët e tij muslimanë anekënd Kosovës, Maqedonisë, Sanxhakut, Bosnjës, Kroacisë. Ishte i palodhshëm edhe në shpërndarjen e literaturës islame (gazetave, revistave, broshurave, librave) si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë boshnjake në ish-Jugosllavi. Përveç idesë mbarë shqiptare, tek ai dominonte ideja universale islame, ashtu që përherë mbetet në kujtim thënia e tij e mirënjohur që e citonte shpesh: "Tungjatjeta gjer në Kaçanik, salam alejkum gjer në Indonezi".



Me daljen në skenë të UÇK-së u gëzua pa masë sepse e dinte se vetëm me luftë të armatosur Kosova mund të fitonte lirinë. Ashtu siç ka qenë në lëvizje gjithëherë, ashtu edhe në lëvizje u vra nga forcat policore ushtarake serbe, më 21 korrik 1998, me rastin e ofensivës në Rahovec, pasi që nuk desh të largohej nga Rahoveci. As sot e kësaj dite, që nga vrasja e tij nga forcat serbe, nuk është gjetur trupi i tij. As varri i tij nuk dihet. Poeti, shkrimtari, studiuesi nga Gjakova Mexhid Yveysi, i cili e kishte mik shpirti, në një poezi të shkruar në nëntor 1998, që i ka kushtuar Haxhi Hasan Vuçitërnës, me titull "Kosova do t' jetë varri i tyre", ndër të tjera shkruan:

"...Juve mos t'ju ligështojë
Hidhërimi e dëshpërimi
Për varrin tim pa nishan,

Nishani im është imani,
Këtë le ta di dushmani.
Kosova do t'jetë varri i tyre...!"

Haxhi Hasan Vuçitërna (1919-1998), ky burrë i shquar, e dha jetën për Kosovën, sikur e kishte dhënë jetën edhe babai i tij, Hoxha, Hasan Vuçitërna, të cilin e ka vranë ushtria serbe në vitin 1918, tre-katër muaj pa lindur haxhi Cana, pra, babë e bir rënë dëshmorë për Kosovë.

Rashid Gorani - pinjoll i familjes me virtyte të larta fetare dhe kombëtare

Personaliteti i tretë i çmuar ishte Rashid Gorani nga Peja. Ai rridhte prej familjes së njohur pejane Gorani, e cila çmohej për virtytet e larta fetare dhe kombëtare. Qysh i ri u dallua në shoqëri sepse kishte një interesim të madh për fe e atdhe. Familja e tij në Pejë ishte e njohur edhe për traditën e mirëmbajtjes se topit, për sinjalizimin e kohës së iftarit gjatë muajit të Ramazanit, një traditë e bukur që mirëmbahej dhe praktikohej në qytetet më të mëdha të Kosovës, si në Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjakovë. Por kjo traditë e bukur nuk shikohej me sy të mirë nga komunistët dhe nga viti 1949 u ndalua në tërë Kosovën. Me çlirimin e Kosovës, në qershor të vitit 1999, si gjithë të tjerët u gëzua edhe Rashid Gorani, por gëzimi i tij e kishte edhe diçka: topin e muajit të Ramazanit, pra, ripërtëritjen e traditës për të njoftuar me krismën e topit gjithë Pejën se iftari është hazër. Me një dëshirë të tillë të zjarrtë, ai menjëherë pas luftës, e priti me padurim muajin e bekuar të Ramazanit dhe filloi ta pastrojë topin, të cilin e kishte fshehur nën tokë, para pesëdhjetë viteve...! Tashmë topi ishte gati, për iftarin e parë, në Ramazanin e parë në liri, por ndodh një tragjedi, një fatkeqësi... Kur e shkrep topin, topi krisi... Por një sasi baruti eksplodoi jashtë grykës, ra në trupin e Haxhi Rashidit, i cili duke dhënë shpirt arriti të thoshte fjalët e fundit: "A e ndiu krejt Peja krismën e topit...!"

Në përfundim të këtij shkrimi, me pak fjalë, vërtet këta tre burra të shquar më kanë frymëzuar. Lutem, që në jetën e vërtetë, All-llahu i Madhëruar, i ka vendosur në Xhennet!

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Parlamenti Evropian inkurajon ve

Demir RESHITI

Ishujt Maldive, shtet që shtrihet në Oqeanin Paqësor, u bë shteti i 55-të anëtar i OKB-së që e ka njohur republikën e Kosovës.

Kosova gjatë muajit shkurt ka qenë relativisht e pranishme në agjendën e institucioneve ndërkombëtare.

Parlamenti Evropian në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt, ka nxjerrë një rezolutë me të cilën i inkurajon vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, që ta bëjnë këtë. PE në rezolutën e miratuar me 424 vota për dhe 133 kundër, po ashtu ka përhëndetur vendosjen e suksesshme të EULEX-it në gjithë territorin e Kosovës, përfshirë edhe në veri të Ibrit, duke përsëritur kundërshtimin e mundësisë së copëtimit të Kosovës.

Për Kosovën është diskutuar edhe në Krakov të Polonisë, në samitin joformal të ministrave të mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s. Ministrat e NATO-s janë shprehur të kënaqur me bashkëpunimin e KFOR-it dhe EULEX-it në Kosovë.

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit shkurt 2009.

(1 shkurt) Munter: Çështja e Kosovës ka marrë fund



Kameron Munter

Beograd - Ambasadori i SHBA-së në Beograd Kameron Munter, ka thënë se çështja e Kosovës ka marrë fund, sepse është zgjidhur statusi i saj dhe se rihapja e kësaj çështje është joreale. Munter ka thënë se liderët institucionalë të Serbisë dhe të Kosovës do të duhej të bisedonin

si fqinjë dhe t'i zgjidhin problemet në mënyrën më të mirë të mundshme.

(2 shkurt) Gjukanoviq: Marrëdhëniet diplomatike mes Prishtinës dhe Podgoricës do të vendosen së shpejti

Podgoricë - Kryeministri malazez, Milo Gjukanoviq ka deklaruar se marrëdhëniet diplomatike ndërmjet Prishtinës dhe Podgoricës do të vendosen së shpejti. Në një intervistë dhënë agjencisë së lajmeve "Beta", Gjukanoviq, ka përsëritur interesimin e Podgoricës zyrtare që: "Malazezët në Kosovë, të trajtohen me të drejta të plota, si shqiptarët në Malin e Zi".

(3 shkurt) Bakojanis: Qëndrimi i Greqisë rreth pavarësisë së Kosovës mbetet i pandryshuar



Dora Bakojanis

Prishtinë - Shefja e diplomacisë greke, Dora Bakojanis, ka deklaruar në Prishtinë se qëndrimi i Greqisë rreth pavarësisë së Kosovës mbetet i pandryshuar. Megjithatë, sipas saj, Greqia mbetet e angazhuar në EULEX-in, KFOR-in dhe në mekanizmat e tjerë që asistojnë në Kosovë.

(5 shkurt) Parlamenti Evropian inkurajon njohjen e Kosovës nga të gjitha vendet anëtare të BE-së

Bruksel - Parlamenti Evropian (PE) inkurajon vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, që ta bëjnë këtë. PE në rezolutën e miratuar më 5 shkurt, me 424 vota për dhe 133 kundër, po ashtu ka përhëndetur vendosjen e suksesshme të EULEX-it në gjithë territorin e Kosovës, përfshirë edhe në veri të Ibrit, duke përsëritur kundërshtimin e mundësisë së copëtimit të Kosovës.

(6 shkurt) Moratinos: Spanja refuzon njohjen e Kosovës

Madrid - Ministri i Jashtëm i Spanjës, Miguel Angel Moratinos, ka refuzuar thirrjen e Parlamentit Evropian që pavarësia e Kosovës të njihet nga të gjitha vendet e BE-së. "Ne respektojmë të gjitha rezolutat e Parlamentit Evropian, por qeveritë kanë opinionet e tyre" - ka thënë Moratinos, duke shtuar se shumica e vendeve anëtare të OKB-së nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

(9 shkurt) Dijakonesku: Rumania nuk e ndryshon qëndrimin ndaj Kosovës

Bukuresht - "Rumania nuk e ndryshon qëndrimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës, që është në kundërshtim me normat dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare" - ka thënë Shefi i diplomacisë rumune, Kristian Dijakonesku.

(11 shkurt) Ishinger: Prishtina dhe Beogradi duhet të bisedojnë vetëm për çështje praktike



Wolfgang Ishinger

Prishtinë - "Ndarja e Kosovës nuk është zgjidhje, ndërsa Prishtina dhe Beogradi duhet të bisedojnë vetëm për çështje praktike në interes të njerëzve dhe jo për statusin, i cili tashmë është zgjidhur". Kështu ka thënë në një intervistë ekskluzive për Radio Kosovën ish-ndërmjetësi në bisedimet për statusin e Kosovës, diplomati gjerman, Wolfgang Ishinger.

(12 shkurt) Rehn: Integrimi i Serbisë nuk lidhet me Kosovën

Bruksel - Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Oli Rehn, ka deklaruar se procesi i integritimit të Serbisë në Bashkimin Evropian nuk ndërlidhet

ndet e BE-së për njohjen e Kosovës

me statusin e Kosovës. "Qëllimi i BE së është përmirësimi dhe mbështetja e zhvillimit të situatës sociale dhe ekonomike në Kosovë" - ka thënë Rehn, duke theksuar se gjatë vitit do të publikohet raporti për situatën në Kosovë.

(13 shkurt) Peticion Konferencës Islamike për Kosovën

Tiranë - 50 mijë nënshkrime të qytetarëve të Shqipërisë janë grumbulluar në një peticion, i cili do t'i dërgohet Organizatës së Konferencës Islamike. Peticioni kërkon nga vendet anëtare të kësaj organizate të njohin pavarësinë e Kosovës.

(14 shkurt) Dubins: Kosova është kthyer në një faktor stabiliteti në rajon

Nju Jork - "Në përvjetorin e parë të pavarësisë, arritjet e Kosovës meritojnë të lavdërohen" - ka thënë analisti amerikan James Dubins, drejtor i Qendrës për Sigurimin Ndërkombëtar. "Kosova është kthyer në një faktor stabiliteti në rajon, me gjithë problemet e mëdha që duhet të zgjidhë për të gëzuar pavarësinë e plotë" - ka thënë Dubins.

(15 shkurt) Jones: SHBA-ja mbështet dialogun nëse bien dakord palët

Pragë - "SHBA-ja ka vullnet të ulët në tryezën e bisedimeve ndërmjet Kosovës e Serbisë, nëse ftohet për të ndihmuar ecjen përpara të këtij procesi. Por, që kjo të ndodhë, varet nga palët" - ka deklaruar në një intervistë për Radio Evropa e Lirë, zv/ndihmës-sekretari amerikan i Shtetit, Stuart Jones.

(16 shkurt) Obama uron përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës



Barack Obama

Uashington - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama, i ka dërguar presidentit të Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiut, një letër urimi me rastin e 17 Shkurtit, përvjetorit të parë të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Telegramet urimi liderëve të Kosovës u kanë arritur nga shumë burështetas të vendeve që e kanë njohur republikën e Kosovës.

(18 shkurt) Uisner: SHBA-ja do të garantojë që Kosova të jetë e suksesshme si shtet

Uashington - Ish-përfaqësuesi amerikan në bisedimet për statusin e Kosovës, Frank Uisner, ka vlerësuar se 12 muajt e parë të pavarësisë së Kosovës kanë qenë të suksesshme, pothuajse në çdo aspekt dhe ka theksuar rëndësinë parësore që ka ekonomia e vendit për suksesin e mëtejshëm të shtetit më të ri të Evropës. "Shtetet e Bashkuara pa fije dyshimi do të vazhdojnë të jenë një mik i madh dhe i mirë i Kosovës" - ka thënë ky diplomat amerikan.

(19 shkurt) Ishujt Maldive njohën shtetin e Kosovës



Ishujt Maldive

Male - Ishujt Maldive e kanë njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës. Këtë e ka konfirmuar ministri i Jashtëm i Maldiveve, Ahmed Shaheed, fillimisht kryetarit të Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacollit, e më pas edhe ministrit të jashtëm të Kosovës Skënder Hysenit. Maldive, që shtrihet në Oqeanin Paqësor, bëhet shteti i 55-të anëtar i OKB-së, që e njeh Republikën e Kosovës.

(20 shkurt) Ministrat e NATO-s shprehën të kënaqur me bashkëpunimin e KFOR-it dhe EULEX-it

Krakov - Në samitin informal në Krakov të Polonisë, ministrat e mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s u kanë bërë thirrje serbëve të Kosovës, që në një numër sa më të madh, të angazhohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministrat e NATO-s janë shprehur të kënaqur me bashkëpunimin e KFOR-it dhe EULEX-it në Kosovë.

(24 shkurt) BE i kërkon Beogradit qasje konstruktive ndaj Kosovës, veçmas ndaj EULEX-it



BE

Bruksel - Ballkani Perëndimor ka qenë pjesë e debateve joformale në takimin e ministrave të jashtëm të BE-së. Shefat e diplomacisë evropiane i kanë kërkuar Beogradit qasje konstruktive ndaj Kosovës, veçmas ndaj EULEX-it. Ata kanë kritikuar edhe politikën serbe ndaj Kosovës më 17 shkurt, përkatësisht vizitat e parlamentarëve dhe qeveritarëve serbë në 1 vjetorin e pavarësisë.

(27 shkurt) Grupi Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën ka vlerësuar të arriturat e përgjithshme në Kosovë

Vjenë - Grupi Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën në takimin e mbajtur në Vjenë ka vlerësuar të arriturat e përgjithshme në Kosovë, me theks të veçantë ndërtimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në takim është biseduar edhe për shqetësimet e ish-pjesëtarëve të TMK-së që nuk janë përfshirë në FSK, të cilat është vendosur që të shqyrtohen personalisht nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Skefer. Këtë e ka bërë të ditur ministri Fehmi Mujota, i cili në këtë takim ka prezantuar të arriturat në ndërtimin e FSK-së. ■

Histori Islame (28)

Çlirimet (pushtimet) e tokave

Kur është fjala për sukseset e arabëve dhe të Aleksandrit të Madh, historianët mbeten pa tekst. Shikuar nga këndi i një muslimani, këto suksese i atribuohen Krijuesit të botëve. Aleksandri i Madh ishte Dhulkarnejeni i theksuar në Kur'an, ndërsa detyra e tij ishte të shkatërronte rëndë çdo mbret tiran, i cili terrorizonte popujt të cilët ishin nën pushtetin e tij. Ndërsa arabët e shekullit të VII-të, mesazhin e Zotit e kishin kuptuar ngjashëm me atë të Dhulkarnejit



Muhamed J. KAJOLLI

Në literaturën arabe (Islame) pushtimet herë kuptohen si pushtime, e herë si çlirimet. Pushtuesit e shumtë të tokave arabe, përgjatë historisë, janë quajtur pushtime, ndërsa pushtimet e Aleksandrit të Madh p.sh. i kanë emërtuar me termin çlirimet. Ajo që më ka lënë të habitur është fakti se edhe persët e muslimanizuar, pushtimet e Aleksandrit të Madh i quanin çlirimet. Ky është edhe sekret i suksesit të tij dhe të arabëve. Sukses i cili, deri tani, nuk u arrit nga askush në botë.

Serbët, amerikanët që erdhën në Kosovë i quajnë pushtues, ndërsa ne, shqiptarët amerikanët i quajmë çlirues. Pra, dallimi është tek ndjenja e vetë individit, goftë i vetëm ose në kolektiv. Kështu, 'pushtimet' e Aleksandrit të Madh pushtetarët e Darit të III-të i konsideronin pushtime, prandaj kishte dalë me ushtrinë e vet ta luftonte atë. Me humbjen e Darit të III-të, Aleksandri marshonte si triumfues deri në Indi. Në Babiloni dhe në Egjipt u prit me ceremoni festive, pikërisht sikurse forcat e NATO-s në Kosovë.

Dalja në skenë e drejtësisë së muslimanëve, shkaktonte trazira në vendet ku kishin dëgjuar për ushtrinë muslimane. Ndërsa analistët e huaj (jo musliman) pretendojnë se pushtimet arabe ishin bërë me anë të forcës, gjë që për muslimanët nuk është e vërtetë. Të analizuarit e situatës së atëherëshme, me logjikën e sotme, nuk mund të duket reale. Disa të tjerë thonë se Ebu Bekri u detyrua të sulmonte shtetet fqinje për shkak të trazirave që e kishin kapluar Gadishullin Arabik, pas vdekjes së

Muhammedit s.a.v.s. Mendoj se e kanë gabim. Trashëgimtari (Kalifi) i Muhammedit s.a.v.s., Ebu Bekri, shkante mbas hapave të mësuesit të tij, ndërsa ai iu kishte thënë se Islami është fe universale dhe ai duhet të përhapet në gjithë njerëzimin.

Arabët, para se të fillonin çlirimet e tokave jashtë Gadishullit, pretendimet nacionaliste, egon dhe pasurinë i kishin mënjanuar, për të mos thënë i kishin gëpusur thellë në tokë. Besimtarët e parë nuk e shikonin veten të pasur në këtë botë. Për ta, e tërë pasuria e kësaj bote i takonte Krijuesit të botëve. Motivët e tyre për çlirimet e tokave i bënë të patrembur përballë çdo ushtrie që i dilte përpara. Ata nuk do të pyesnin asnjëherë sa është forca kundërshtarë para tyre. Ata në kokat e tyre kishin ngulitur detyrat e mesazhit hyjnor, të cilat duhej t'ua përcjellin sa më shpejt të ishte e mundur popujve të tjerë. Kështu i thoshte Halidi Hurmuzit, njërit prej prefektëve të Persisë: "Pranoje fenë islame, do të kesh paqe, ose nëse e paguani xhizjen do të jetoni nën qeverisjen e ligjeve të Islamit. Ndryshe përgatitu, sepse unë po të vij me një popull që e do vdekjen, ashtu sikurse ju që e doni jetën". (Ejub: 2003, f. 58)

Betejat për çlirimet e Persisë -mars, prill 633

Sidoqoftë, them se çlirimet arabe nuk kishin karakter pushtues. Ebu Bekri e urdhëroi Halid ibn Velidin të përgatiste ushtrinë e tij për të marshuar drejt tokave perse, në mars të vitit 633, ose Muharrem 12 hixhri. Halidi, si komandat i shquar, ushtrinë e tij për në Persi e ndau në dy pjesë. Njërin e drejtoi vetë drejt Gjirit Persik, ndërsa pjesën tjetër e nisi drejt segmentit Medine-Hire. Ushtria muslimane, për dallim nga ushtritë e tjera, kishte urdhër që të mos mbyste pleq, gra, fëmijë dhe njerëz të paarmatosur.

Vendi i parë i cili do të çlirohej ishte Kadhime, një vendbanim brenda territorit të Kuvajtit të sotëm. Ushtria e tij u përball me ushtrinë e Hurmuzit, të cilën e theu shpejt. Aty u zhvillua një dyluftim midis Halid ibn Velidit dhe komandantit të ushtrisë perse. Me këtë humbje, ushtria perse ia mbathi me të katra, ndërsa perandori i inatosur për këtë humbje, gjegjësisht largimin e ushtrisë së tij, shpejtoi për të dërguar një ushtri tjetër shtesë në ndihmë të tyre. Halidi nuk e la të qetë atë ushtri, por ju qep nga prapa, derisa e takoi në vendin e quajtur Elba. Një vendbanim në deltën



Tokave jo muslimane

e lumenjve Euftrat dhe Tiger. Pas një përleshje të vogël, ushtria perse, e cila ishte në ikje, nuk arriti të shkonte drejt rrugës nacionale, për t'u takuar me ushtrinë e dërguar nga perandori. Ajo iku drejt qytetit Medhar.

Halidi ishte strateg i njohur. Usharakët e vlerësojnë si komandantin më të shquar të shtetit islam. Ky njeri nuk ka humbur asnjë betejë në jetën e vet. Duke qenë se e dinte artin ushtarak, ky e ndoqi ushtrinë e Hurmuzit me qëllim që të mos takohej me ushtrinë e perandorit, prandaj, iu vu prapa. Në vendin e quajtur Medhar, Halidi, pas një përleshje të shkurtër por të ashpër, korri suksesin e radhës. Taberiu thotë se aty u vranë afër 30.000 ushtarë.

Halidi sërish u kthye në Elba. Aty la një numër ushtarësh dhe marshoi drejt qytetit al Uexhle. Ky qytet dhe

trinë muslimane me shumë entuziazëm. Tokat çliroheshin pa ndonjë rezistencë të madhe. Për dy muaj, ushtria e Halidit arriti deri në Humus të Sirisë së sotme. (Munis: 111). Por derisa ai ishte në tokat perse në qytetin Dumetul Xhedel, plasi një kryengritje. Halidi u detyrua të kthehet prapa në Gadishullin e Arabisë për ta shuar këtë kryengritje.

Pasi Halidi arriti ta stabilizojë vendin, Kalifi i muslimanëve po mendohej që të drejtonte një ushtri tjetër drejt veriut. Muslimanët mëtojnë tokat bizantine.

Çlirimet Jordanisë dhe Sirisë së sotme

Suksesi i Halidit i dha kurajë Kalifit që të caktojë për në Sham (Siri) Amër

Çlirimet e Halid Ibn Uelidit: mars-prill 633 ose Muharrem-Sefer 12 hixhrij

01.	Kadhime	05.	Elis	09.	Ajnu Temer
02.	Elba	06.	Umgishija	10.	Dumetul Xhendel
03.	El Medhar	07.	El Hire	11.	El Furas
04.	El Uelxhe	08.	El Enbar	12.	El Ridab
13.	Drejt Humusit në tokat e Sirisë veriore				

Medhar-i ishin larg Elba-s rreth 300 km, njëra nga lindja, ndërsa tjetra nga perëndimi. Aty në Uelxhe, Halidi u prit nga ushtria shtesë e perandorit pers, por ai, pa ndonjë problem, e theu edhe atë. Halidi marshoi përgjatë lumit Euftrat në veri. Betejat që u zhvilluan përgjatë këtij marshimi ishin Elis, Umgishija dhe, më pas, arriti në Hire. Ky vend u bë qendra kryesore e ushtrisë muslimane për një kohë të gjatë. Pra, betejë pas beteje, ushtria e Halidit arriti në Hire, ndërsa pjesa tjetër e ushtrisë së tij, e cila ishte nisur nga Medina arriti në Hire pa asnjë betejë.

Muslimanët po korrnin fitore të njëpasnjëshme. Pasi u stabilizuan mirë e mirë në Hire, ushtrinë e tij e ndau në tri pjesë për të vazhduar më tutje, drejt çlirimit të tokave të reja. Populli pers dhe arabët e Irakut të sotëm e pritën ush-

trinë Asin, Jezid ibn Sufjanin, Ubejde ibn Xherrahun dhe Sherhabij ibn Hasenen. Ushtrinë e ndau në katër drejtime. Kjo ushtri nuk ishte më e madhe se 36 mijë ushtarë.

Herakliu kur mësoi për sukseset e ushtrisë muslimane në Persi dhe marshimin e ushtrisë tjetër për në tokat e tij, filloi përgatitjet serioze. Si duket, ndarja e ushtrinë në katër drejtime nuk ishte veprim i mençur, prandaj pasi kishin nuhatur forcën e madhe të armikut në terren, kërkuan nga kalifi që t'iu jepte pëlqimin për ta bashkuar ushtrinë me ata komandantë. Pasi morën pëlqimin e Kalifit, ushtria muslimane u bashkua në vendin e quajtur Jermuk, por nuk zgjodhën një komandant të vetëm.

Herakliu po i përcillte me vëmendje lëvizjet e muslimanëve. Ai kishte dalë me një ushtri të madhe (rreth 200 mijë forca)

dhe kishte zënë pozitat më të mira, për të mos depërtuar ushtria kundërshtare nga prapa. Një strategji tjetër, e paparë ndonjëherë në fushëbetejat e asaj kohe, ishte se Herakliu i kishte lidhur ushtarët e tij këmba këmbës, për të mos ikur nga pozicionet e tyre. Si duket ishte përhapur lajmi se muslimanët ishin luftëtarë shumë të guximshëm dhe të pathyeshëm.

Pozitat ishin zënë aq fort, sa që depërtimi dhe shpërthimi ishte i pamundur. Ushtritë po vëzhgonin njëra-tjetrën, por asnjëra nuk merrte guximin që të sulmonte e para. Derisa situata po vëzhgohej kështu, kalifit Ebu Bekër i arrin një letër nga Jermuku. Atij i kërkohet ndihmë. Ebu Bekri urdhëroi Halidin që të shkonte atje dhe i kërkoi atij që në Hire të lërë komandant El Muthena ibn Harithe Esh-Shejbaniun. Halidi do të nisej, por me vete nuk do të merrte më shumë se 10.000 ushtarë.

Shumë letrarë dhe historianë e përshkruajnë udhëtimin e tij në shkretëtirën Sua. Kjo duhej të kalohej për pesë net, për më tepër me ngarkesë të rëndë luftarake. Ajo që i bëri heronj ata ishte vullneti i madh për t'i ndihmuar vëllezërit e tyre në Jermuk dhe, kuptohet, strategjia e Halidit. Askush më parë nuk kishte udhëtuar në atë shkretëtirë me ngarkesa për luftë, përveç Halidit. Udhërrëfyti atë e quajti fodull, por, ai ashtu kishte vendosur. Do të vdesim në shkretëtirë, thoshte udhërrëfyti. Halidi ngarkoi shumë ujë dhe, gjithashtu, stërngopi me ujë edhe devetë. Në thellësi të shkretëtirës, kur ju mbaroi uji, kur të gjithë mendonin se ky ishte fundi i tyre, ai urdhëroi të theren devetë në vendin ky ato depononin ujin e tyre. Ua nxori ujin, aq sa të merrnin forca të reja për marshim. Kështu e kaloi shkretëtirën.

Beteja e Jermukut

Historianët muslimanë janë të pasaktë për vitin e ndodhjes së kësaj beteje. Disa mendojnë se kjo betejë ka ndodhur para çlirimit të Damaskut, në vitin 13-të hixhri (634). Disa të tjerë, sikur Hafidh bin Asakir, thonë se beteja ka ndodhur pas çlirimit të Damaskut, në vitin 15-të hixhri. (Bidaje we Nihaje: V-5, f. 233) Ndërsa historianët bizantinë mendojnë se kjo betejë nuk ka ndodhur fare. Si duket është shfrytëzuar kjo pasaktësi e historianëve muslimanë.

Sidoqoftë, një numër më i madh i historianëve muslimanë janë të mendimit se kjo betejë ka ndodhur në vitin 13-të hixhrij.

Pa marrë parasysh vitin e ndodhjes, si mund të shpjegohet dëbimi i Herakliut nga tokat e perandorisë së tij pa asnjë luftë? Ndryshe si mund të kuptohet thënia e Herakliut rreth Sirisë: “Të përshëndes moj Siri me një përshëndetje, pas së cilës nuk do të shihemi më” (Ejub: f. 69). Kjo thënie e famshme është e vërtetuar edhe ndër historianët bizantinë.

Arritja e ushtrisë së Halidit i gëzoi ushtarët që ishin në Jermuk. Meqenëse ata ishin katër komandantë dhe i pesti tani ishte në mesin e tyre, Halidi propozoi që të zgjidhej vetëm një komandant. Ai nuk do të luftonte me ushtarë të ndarë.

Se sa ishin të përpiktë muslimanët, flet fakti se ata nuk donin që t'i ndryshonin komandantët, sepse kështu kishte urdhëruar Kalifi Ebu Bekër. Propozimin që ua ofroi Halidi i vuri në pozicion të vështirë, por e thyen urdhrin e Kalifit. Halidi thoshte: beteja nuk fitohet me shumë komandantë, prandaj ju them se secili komandant nga ne do të zgjidhet për çdo ditë. Ditën e parë do të ishte komandant Halid Ibn Velidi.

Për të mos e përshkruar betejën në hollësi, ditën e parë të betejës, ushtria muslimane korri suksesin më të madh. Si duket, lidhja këmba-këmbë e ushtrisë së Herakliut iu kushtoi atyre shumë, sepse u mposhtën shumë shpejt. Beteja zgjati deri në orët e vona të natës. Beteja përfundoi me futjen e Halidit në tendën e kryekomandantit të ushtrisë bizantine.

Vdekja e Ebu Bekrit

Ebu Bekri, para se të ndërronte jetë, me shumë vështirësi pranoi këshillat e shokëve të tij që Kur'ani të mblidhet në një kopertinë (mus'haf). Shteti islam po zgjerohej dita ditës dhe në luftë vriteshin hafizë të Kur'anit. Deri në këtë kohë, Kur'ani ishte i tubuar, por nuk ishte në një kopertinë (mus'haf). Për ta ruajtur nga ndryshimet eventuale që mund të ndodhnin në të ardhmen, ai formoi komisionin për përmbledhjen e ajeteve. Si kryesues të komisionit për përmbledhjen e Kur'anit ishin zgjedhur Zejd ibn Thabiti për të gjithë ata që e kishin të shkruar, ndërsa Ali ibn ebu Talib për të gjithë ata që e citonin përmendsh. Pasi u përmbledh në një kopertinë (mus'haf), atë ia dorëzuan Kalifit, ndërsa ky ia dorëzoi njëres prej grave të Pejgamberit s.a.v.s., Hafsasë.

Ebu Bekri ndërroi jetë dy vjet pas shokut të tij më të ngushtë, Muham-
Si kandidat
me aklama-
Kalif zgjodhi
Hatabin. ■

medit s.a.v.s.
të mundshëm,
cion, për
Omer ibn



Leximi i poezisë

Kulti i antikës



Milazim KRASNIQI

Njëri nga poetët më të shquar grekë e evropianë, fituesi i Çmimit Nobël për letërsi, Jorgo Seferisi, në poezinë e vet e riafirmonte mitologjinë politeiste antike greke me një pasion të thellë. Madje edhe në arsyetimin e dhënies së Çmimit Nobël, ky aspekt vihet në spikamë posaçërisht, kur për poezinë e tij thuhet: “Poezi e jashtëzakonshme lirike, e frymëzuar nga ndjenja e thellë e kulturës greke”.

Në shumë poezi të Seferisit, figura dhe koncepte poetike me prejardhje antike, politeiste, kontekstualizohen, për të shenjuar edhe problemet e kohëve moderne. Botëvështrimi i huazuar antik, në esencë thellësisht politeist, shfrytëzohet pa asnjë distancë, pa asnjë rezervë. Edhe përzierja e perspektivave të ligjërimit poetik, alternimi i të kaluarës me të tashmen (të tashmen e ligjërimit poetik) është organike. Koha reale e ligjërimit poetik, po ashtu, shpërfaqet me një shtresë të fortë mitologjike.

Poezia shumë e njohur e Seferisit, “Helena”, është një kombinim me disa replika nga tragjedia “Helena” e Euripidit. Pastaj Seferisi ndjek jo vetëm idenë e Euripidit, sipas të cilës Paridi u kthye në Trojë me fantazmën e Helenës e jo me Helenën, por ndjek edhe botëvështrimin antik politeist:

*Jetova një jetë të tërë, duke dëgjuar emra, që s'i ka dëgjuar kush:
Vende të reja, marrëzi të reja njerëzish
Apo Zotash.*

Pra, sipas këtij botëvështrimi, kishte më shumë zota dhe ata potencialisht ishin subjekte të marrëzive, ashtu si edhe janë funksionet e tyre në mitologjinë antike greke. Më tutje, Seferisi shpalos një tablo poetike, ku fatin e njeriut e sheh të luhetat në një botë antike:


*Fati im që luhetat
në mes shpatës së një Ajaksi dhe një tjetre Salamine,
më zvarriti deri këtu, në këtë breg.*

*Hëna
doli nga deti si Afërditë*

Shihet qartë se me figura mitologjike, me toponime, me krahasime poetike, ndërtohet tabloja e një botëvështrimi krejt identik me atë të antikës. Në vazhdim të kësaj poezie, Seferisi bën një hap edhe më radikal, nga politeizmi, drejt mohimit, gjë që e risjell në kohën e vet të krizës së besimit:

O bilbil, bilbil, bilbil,

politeiste në vargun e Seferisit



*çështë vallë Zoti? Çështë
vallë jo Zoti?
Çfarë ka në mes njërit dhe
tjetrit?*

Në poezinë “Helena”, Seferisi në fakt ngre një dilemë aktuale: a mund të ndodhë sërish e sërish që të rrjedhë gjaku e të bëhet hataja, për një gjë koti, si tunika e Helenës, e asaj gruaje, këmba e së cilës kurrë nuk

shkeli në Trojë, por Troja u bë shkumb e hi për shkak të gjoja rrëmbimit të saj dhe sjelljes në Trojë si nuse e rrëmbyer? Me një fjalë, a mund të ndodhë sërish mashtrimi, falsifikimi i fakteve? Por Seferisi nuk e ndërton dilemën aktuale duke prekur plagën e çrregullimeve sociale e gjeopolitike të botës në të cilën vet jeton. Ai dilemën e motivon duke i akuzuar hyjnitë. Krejtësisht sipas botëvështrimit antik për karakterin intrigant të tyre. Po ashtu, poeti e risjell në kujtesë mundësinë e hakërrimit të luftëtarëve të vjetër, Ajaksit e Priamit, që mund të bëjnë sërish gjakderdhje dhe në fund të merret vesh se e tëra ka qenë një luftë koti, pra, duke mos kërkuar pas akterëve të rinj të çrregullimit të botës, po duke mbetur i fiksuar te heronjtë antikë. Përjetimi mitologjik i botës, edhe kur u referohet dilemave të aktualitetit, dëshmon për avantazhin që i jep poeti të menduarit të ngurtësuar dhe botëvështrimit politeist mbi botën.

Në një tjetër poezi me titull “Sipas mënyrës së J. S”, me nëntitull që tregon një përjetim të vërtetë të poetit (Në vaporin Aulida, në pritje në nisjes. Verë, 1936), poeti e ndërfton perceptimin e të kaluarës mitologjike në jetën e vet reale. Pas vargut “Ngado që të udhëtoj, Greqia më hap plagë”, i cili është me theksim personal dhe i adresohet kohës reale të poetit, kur ai edhe e përjeton ngjarjen e edhe e shkruan poezinë, ligjërimi poetik zhytet në mjegullat e mitologjisë antike.

*Në Mikenë mbarta shkëmbinj
dhe thesaret e Artridëve
dhe u preha me ta*

*në bujtinën “Helena e bukur e Menelaut”,
m’u zhdukën në agim, kur piskati Kasandra,
që mbante pezull një këndez nga qafa e zeshkët.*

Të gjitha shenjat janë me prejardhje homerike, pra nga lufta e Trojës. Më vonë bëhet një kombinim i vargjeve me fakturë kolokviale, të kohës aktuale, për të konstituuar idenë e Greqisë në udhëtim dhe të vetë poetit në një përhumbe ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes, e cila shenjohe në vargun e fundit: Anija që udhëton quhet AGONIA 937

Në poezinë “Mbi një varg të huaj”, e cila ka një nëntitull in-dikativ, “Krishtlindje, 1931”, prirja e botëvështrimit mitologjik për botën bëhet dominuese edhe në një datë aq të veçantë kristiane, si krishtlindja. Adresimi për festën e shënuar kristiane

mbetet vetëm si një fiksion i një çasti ose i një rrethane, e cila në të vërtetë nuk ka asnjë ndikim mbi ligjërimin poetik që pason. Në fakt, poezia fillon me vargje që risjellin në kujtesë njëherë nga figurat e mëdha të poezisë homerike, njeriun që brodhi gjatë në rrugën e kthimit në atdhe:

*I lumtur kush bëri udhëtimin e Odiseut.
i lumtur, nëse që në nisje, ndjente korracën
e një dashurie t’i mbështetej mbi gjoks, ndjente korracën
si peshën e rrembave kur gufon gjaku*

.....


*Dhe më shfaqet ende para syve fantazma
e Odiseut, me sytë e skuqur nga kripa e detit,
me një dëshirë të thekshme: të shihte tymin
që dilte nga oxhaku i shtëpisë, dhe qenin e tij të plakur,
që e priste e porta.*

*Merr përpjesëtime gjigante dhe murmurit mes mjekrës së thinjur
fjalë të gjuhës sonë, ashtu si flitej
tre mijë e ca vjet më parë.*

Edhe dëshira për kthim në atdhe, është e ngatërruar në përfytyrime mitike e profane, e shumta edhe në një feksje të lehtë të bizantizmit.

Ndërtimi i mëtejme i rrugës poetike të kthimit, bëhet sërish me figura të njohura nga mitologjia: Qiklopi, Shilla, Haridba, Erotokriti, Aretia.

Shfrytëzimi i figurave dhe i botëvështrimit antik është shumë i dendur edhe në poezi të tjera të Seferisit dhe e ekspozon këtë poet si njërin nga pasuesit e fiksuar pas frymës së Rilindjes Evropiane, e cila e absolutizoi kultin e antikës edhe në letërsi. ■



Natyra e gjuhëve semite

Gjuha arabe, në formën e saj klasike, është gjuha origjinale nga e cila kanë rrjedhur gjuhët e ndryshme semite. Ajo ka një kapacitet të rëndësishëm për të shprehur sfera të gjera të eksperiencës dhe ka një fjalë tjetër për çdo nënndarje apo nuancë të domethënies

Mimoza SINANI

Lbulimet arkeologjike të shekujve tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë të e.s. provuan ekzistencën e popujve dhe të gjuhëve, për të cilat studiuesit e Testamentit të Vjetër përdorën emrin semitik. U zbulua se këto gjuhë i përkisnin së njëjtës familjeje demografike. Studimi i mëtejshëm zbuloi lidhje më të afërta midis gjuhëve, që deri atëherë mendohej se nuk ishin të lidhura.

Gjuhët semite janë anëtare të së njëjtës familje. Si të tilla, ato kanë një numër karakteristikash thelbësore, me anën e të cilave mund të identifikohen, dhe të cilat përbëjnë thelbin e tyre:

Trilateraliteti (Treshkronjorshmëria).


Gjuhët semite kanë të përbashkët karakteristikën gjuhësore të trilateralitetit, pra fjalët e tyre përbëhen nga rrënjë me tri bashkëtingëllore secila dhe nga fjalët e prejardhura nga këto rrënjë. Kjo është karakteristikë e veçantë e anëtarëve të kësaj familjeje; asnjë gjuhë tjetër apo familje gjuhësore nuk e ka një veçori të tillë. Lista e temave apo fjalëve-rrënjore mund të ndryshojë nga një gjuhë te tjetra, disa rrënjë janë hequr nga përdorimi dhe të tjera janë huazuar nga gjuhë të huaja. Megjithatë, gjuhët semite ia kanë dalë mbanë që të vazhdojnë të kenë shumicën e fjalëve-rrënjore të tyre të përbashkëta me njëra-tjetrën. Nga këto rrënjë trebaskëtingëlloreshe, fjalët formohen përmes një procesi që quhet “zgjedhim”, që përbëhet nga ndërimi i shqiptimit të tri bashkëtingëlloreve sipas rregullit, apo nga të shtuarit e një apo më tepër bashkëtingëlloreve si parashtesë, prapashtesë, apo bren-dashtesë dhe duke ndryshuar gjithashtu shqiptimin e saj. Çdo formë e zgjedhurar ka si ngjyrim një modalitet të domethënies së rrënjës bashkëtingëlloreshe.

Po t'i vendosim këto modalitete si tituj në dimensionin horizontal dhe rrënjët bashkëtingëlloreshe në dimensionin vertikal, ne do të kemi një rrjet koordinativ në të cilin mund të vendos-

en të gjithë emrat dhe foljet, pra pothuaj e gjithë gjuha, për t'u shqyrtuar dhe kuptuar më qartë.

Gjuha arabe është më e dendura dhe e mbush tërë rrjetin koordinativ, gjë që mbështet pohimin se ajo, në formën e saj klasike, është gjuha origjinale nga e cila kanë rrjedhur gjuhët e ndryshme semite.

Fonetika. Gjuhët semite kanë të përbashkët një alfabet që përbëhet nga 6 tinguj grykorë, dy tinguj qiellzore, dy tinguj buzorë, pesë tinguj uvularë, dy gjuho-dhëmborë, tre tinguj fishkëllorë, gjashtë tinguj lëngëzorë dhe gjashtë tinguj fërkimorë. Asnjë gjuhë apo dialekt semit që ekziston nuk i ka të gjithë ata. Arabishtja ka pjesën më të madhe, njëzet e nëntë nga një total prej tridhjetë e dy. Arabishtja ka më tepër shkronja sesa çdo gjuhë tjetër semite. Është kjo arsyeja për të cilën studiuesit pajtohen se “mund që alfabeti semit origjinal ishte pothuaj identik me atë të arabishtes klasike.”



Gramatika. Gjuhët semite janë të eptueshme (të lakueshme dhe të zgjedhueshme).

Vetëm tri gjuhë eptohen sot: gjuha arabe, amharike dhe gjermane. Shumë gjuhë të së shkuarës ishin të eptueshme, për shembull, akadianishtja, greqishtja, latinishtja dhe sanskritishtja. Gjuhët moderne, në pjesën më të madhe, e kanë humbur eptimin e tyre. Brenda familjes latine eptimin e kanë humbur: frëngjishtja, italishtja dhe spanjishtja. Edhe anglishtja e ka humbur eptimin e saj, ndërsa gjermanishtja e ka ruajtur.

Eptimi është tregues i një prirjeje më ekzigjente, që synon më tepër përpikëri.

Fjalori dhe përpikëria. Gjuhët semite kanë një fjalor të bollshëm, me shumë fjalë

për të njëjtin objekt. Arabishtja i tejkalon të gjitha ato. Arabishtja i jep dritës 21 emra, vitit 24, diellit 29, reve 50, errësirës 52, shiut 64, burimit të ujit 88, ujit 170, gjarprit 100, devesë 255 dhe luanit 350. I njëjti thesar ekziston edhe në lidhje me kafshët e tjera, me shkretëtirën, shpatën, si edhe me karakteristikat njerëzore të gjatësisë (91 fjalë), shkurtësisë (160), kurajës, bujarisë, koprracisë dhe kështu me radhë. Shkrimtari i prozës apo poezisë është i lirë që të zgjedhë, nga spektri i pasur, fjalën që i përshatet veprës së tij më së miri për sa i përket formës, tingullit, gjatësisë, rimës dhe forcës tërheqëse.

Përveç bollëkut të plotë të fjalëve, gjuhët semite kanë një përpikëri të jashtëzakonshme diksioni të përshatshëm gjatë përdorimit të tyre. Nuancat konotative (ngjyruese) të domethënies që perceptojnë semitet shpesh janë të pakapshme për të tjerët. Nga ana tjetër, arabishtja e ka zhvilluar këtë karakteristikë në shkallë të skajshme, duke dhënë një emër të ndryshëm për çdo orë të ditës dhe natës, për çdo natë të kalendarit hënor, për çdo llojshmëri të të parit, të të ulurit, të të ecurit, të të fjeturit, apo të të dashuruarit.

Shkretëtira, shpata, njeriu i gjatë, njeriu i shkurtër, heroi, mikpritësi, koprraci, bujari – të gjitha këto fjalë kanë një numër termash për t'i përcaktuar ato. I shtojmë kësaj faktin se arabishtja është unike me pasurinë e disa qindra fjalëve që bartin një kuptim dhe të kundërtin e tij në të njëjtën kohë. Sikur të mos mjaftonte kjo, disa fjalë bartin tri apo më tepër kuptime në të njëjtën kohë. Leksikologët kanë raportuar njëqind e pesëdhjetë fjalë me tre kuptime, njëqind e pesëdhjetë me katër, njëqind e pesëdhjetë fjalë të tjera me pesë, dhe kështu me radhë shkalla rritet deri sa ato arrijnë tridhjetë e pesë domethënie për fjalën 'ajn (sy) dhe gjashtëdhjetë për fjalën 'exhuz (të moshuarin).

Gjuha arabe ka një kapacitet të rëndësishëm për të shprehur sfera të

gjera të eksperiencës. Ajo ka fjalë që i përkohjnë çdo realiteti dhe ka një fjalë tjetër për çdo nëndarje apo nuancë të domethënies.

Ajo dallon midis deveve të moshave të ndryshme, ngjyrave të ndryshme dhe numrit të ndryshëm të pasardhësve, si edhe midis topografive të panumërta të shkretëtirës, duke i dhënë secilës një emër të ndryshëm. Ajo dallon orët e ditës dhe natës, ndodhjen e tyre gjatë muajve, dhe secilës i jep një emër të ndryshëm.

Sintaksa. Në gjuhët semite, sintaksa qëndron në thjeshtësinë e artikullimit dhe qartësinë perceptuese. Në arabisht, shpesh elokuenca përcaktohet nga forma e përshtatshme, saktësia apo qartësia. Shkurtësia e shprehjes është gjithmonë virtyt letrar; dhe të përmbledhurit e domethënies të rëndësishme në pak fjalë, që mund të kuptohen dhe mësohen përmendsh lehtësisht, është një fuqi e veçantë e të gjitha veprave letrare semite. Për përmbledhjen e përkushtimit, të karakterit moral dhe mençurisë, në numrin më të paktë të fjalëve dhe megjithatë më të fuqishme, Bibla Hebraike dhe Kur'ani nuk kanë të krahasuar. Duke pasur kapacitete të tilla latente (të brendshme) letrare, nuk është për t'u çuditur që gjuhët semite kanë qenë mjeti i komunikimit të profecisë prej kohërave më të hershme.

Një tjetër karakteristikë sintaksore e përbashkët për të gjitha gjuhët semite është mungesa pothuajse e plotë e fjalëve të përbëra. Me sa duket, begatia e sinonimeve dhe fjalët e mëvetësishme për çdo domethënie denotative (kuptimore) dhe konotative (ngjyrimore) në çdo nivel, kanë mënjanuar nevojën për fjalët e përbëra.

Veprat letrare semite

Që nga shpikja e shkrimit, semitët ishin të parët që krijuan prozë dhe poezi letrare, që u angazhuan për të shkruar dhe për t'i ruajtur ato të shkruara në pllaka balte për brezat e ardhshëm.

Estetika letrare qëndron në kombinimin e saktësisë dhe qartësisë me bukurinë dhe efektin emocional. Cilësia estetike lidhet, si rrjedhim, me një frazë, një varg apo një fjali. E gjithë poezia semite është e llojit lirik, që karakterizohet nga paralelizmi i pjesëve të saj, nga autonoma

me e vargjeve të saj dhe natyra jozhvilimore e vazhdimësisë së saj. Veprat letrare semite: Libri Hebraik i Mbretërve, Psalmet, Kënga e Këngëve, mbishkrimet mbretërore akadiane, Epi i Gilgameshit; kasidah arabe; Kur'ani, mekamat; apo Një mijë e një netët, japin përshtypjen e paanësisë së tyre, të mungesës së një fillimi apo një mbarimi. Ndikimi emocional nuk arrin pikën kulmore dhe lehtësimin në fund.

Revelimet gjatë rrjedhës semite të historisë

Revelimi, apo komunikimi i vullnetit të Zotit drejtuar njeriut, ka një histori të gjatë dhe ka marrë forma të ndryshme. Në kohët më të hershme, Zoti e reueloi vullnetin e Tij në mënyrë indirekte nëpërmjet ogureve të natyrës, apo në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet vizioneve dhe ëndrrave, të cilat priftëria ishte mësuar që t'i deshifronte. Revelimi u ruajt duke iu besuar memories.

Teksti më i hershëm i një mesazhi hyjnor, që përmban pretendimin e një shenjtërie të tillë, është Kodi i Hamurabit.

Revelimet e mëhershme gjatë rrjedhës semite të historisë ishin kode të ligjeve të hartuara në prozë tokësore dhe praktike. Revelimet e mëvonshme ishin rrëfime dhe këshilla për devocion dhe dëlirësi, por gjithashtu ishin hartuar në stilin e thjeshtë të gjykimit të përgjithshëm.

Testamenti i Vjetër Hebraik përmbante shumë pasazhe të një bukurie letrare të shkëlqyer. Por askush që beson në burimin hyjnor të Biblës Hebraike nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për hyjninë e saj në bukurinë e saj letrare. Përkundrazi, vlerësimi i çdo bukurie letrare ishte rrjedhim i besimit në origjinën hyjnore të tekstit.

Kur'ani është vepra më e bukur letrare

Rasti i Kur'anit është i kundërt me atë të Biblës. Pa dyshim, Kur'ani është i bukur, në të vërtetë vepra më e bukur letrare e njohur kurdoherë në gjuhën arabe. Bukuria e tij, megjithatë, nuk është pasojë e besimit, por vetë shkaku i tij.

Gjykimi estetik – se Kur'ani është i bukur, madje, sublim – nuk është një shprehje e besimit. Ai është një gjykim kritik, që arrihet nëpërmjet analizës letrare. Bukuria është shkaku dhe dëshmia për origjinën e tij hyjnore.

Islami është unik ndërmjet religjioneve të njerëzimit në mbështetjen e vërtetësisë së shenjtërisë së tij në faktin e bukurisë së tij sublime.

Kur'ani dëshmon një refuzim të zhvillimit narrativ si një parim letrar organizativ. Referimet ndaj ndodhjeve të caktuara trajtohen në mënyrë segmentore dhe me përmendje të përsëritura, sikur lexuesit të ishin tashmë të familjarizuar me ngjarjet dhe karakteret. Qëllimi kryesor nuk është narrativja, por didaktika dhe morali.

Në Kur'anin e Shenjtë ekziston një proces serik i perceptimit dhe i vlerësimit që e sfidon zhvillimin drejt një klimaksi të vetëm kryesor dhe konkluzioni të mëvonshëm. Përshtypja e unitetit të përgjithshëm është e dobët dhe vetëm nëpërmjet përjetimit të pjesëve të tij individuale, një pas një, lexuesi apo dëgjuesi kap një sens të tërësisë.

Kur'ani ndahet në module letrare (ajet dhe suvar), të cilat ekzistojnë si pjesë të plota që qëndrojnë më vete. Çdo modul është i kompletuar dhe nuk varet nga ai që ka kaluar përpara, apo vjen pas tij.

Mjetet poetike që rezultojnë me përsëritje tingulli, apo përsëritje metrike, janë me shumicë në prototipin kur'anor. Përveç shembujve të shpeshtë të rimave fundore një apo shumërokëshe, Kur'ani përmban shumë rima të brendshme në rreshta.

Përsëritjet e njëjse metrike të tingullit të zanores apo bashkëtingëllores janë të shumta dhe e gjallërojnë poetikisht këtë vepër letrare. Frazat dhe rreshtat e refrenit rifillojnë vazhdimisht për të përforcuar edhe mesazhin didaktik, edhe mesazhin estetik.

Paralelizmi, antiteza, metafora, krahasimi dhe alegoria janë vetëm disa prej shumë mjeteve poetike që sigurojnë pasurinë dhe përpunimin fjalësor në Kur'an. Shumëfishimi i këtyre elementeve u shkakton atyre që i dëgjojnë, apo i lexojnë fragmentet e tij, mahnitje me bukurinë dhe elokuencën e tij.

Si një vepër letrare, Kur'ani ka një estetikë të mrekullueshme dhe ndikim emocional mbi muslimanët që e lexojnë apo e dëgjojnë prozën e tij poetike. Madje edhe jomuslimanët janë impresionuar thellësisht nga përkryershmëria e tij letrare dhe perfeksionimi i paimtueshëm i tij. ■

Metakritikë

Modelet e kërkimit

Studimi i Muhamed Çitakut 'Mythos dhe Eidos' ecën nëpër esencat e kërkimeve të ndërtimeve e rindërtimeve të ideve e të mitit personal, që del në shtatë variante në veprën e Koliqit, e cila tani në kritikën e Çitakut bëhet kërkim e analizim i fuqishëm, duke prekur e hetuar shkrimin personal të vetë mitit koliqian.



Flamur MALOKU

Libri studimor i Muhamed Çitakut *Mythos dhe Eidos*, shtreson në tërësinë e kërkimit, çështjen e mitit në veprën personale të Ernest Koliqit *Pasqyrat e Narcizit*. Vetë titulli i tekstit hap shenjën e komunikimit, komunikim ky i dyfishtë, siç thotë edhe vetë studiuesi, por jo duke përcaktuar metodë të veçantë studimi. Çitaku këtë e bën me vetëdije të plotë duke u nisur nga ajo, se teksti letrar është përherë i konotushëm, aq më shumë kur tani Çitaku në venerimin e tij ka përballë mitin e Narcisit në shtatë novelat e Koliqit.

Variantet personale

Teksti letrar është i konotushëm. Duke ndërtuar e rindërtuar ide jeton në kohë, bëhet universal e çdoherë i prekshëm e personal. Andaj, studimi i Muhamed Çitakut *Mythos dhe Eidos* ecën nëpër esencat e kërkimeve të ndërtimeve e rindërtimeve të ideve e të mitit personal, që del në shtatë variante në veprën e Koliqit, e cila tani në kritikën e Çitakut bëhet kërkim e analizim i fuqishëm, duke prekur e hetuar shkrimin personal të vetë mitit koliqian. Miti personal i Koliqit bëhet ide e kërkim. Idetë e venerimit e të kërkimit shkojnë e thellohen, duke gjetur e hulumtuar nëpër literaturë arkimitin. Arkimite preket e strukturohet, duke i dhënë studiuesit mundësi të mëdha për një kategorizim e për një identifikim të plotë. Shenjat e analizimit sa vijnë e shtresohen, duke u bërë edhe shkrim përjetimi gjatë hetimit të mitit të Narcisit në shtatë novelat e Koliqit. Shtatë novelat e Koliqit, bëhen nga analizim i shenjave të brendshme, shenja nëpër të cilat bëhet edhe sintetiz-

imi-strukturimi, duke ardhur gjithnjë te statusi tematik e ai final i vetë novelave. Rrallëkush i lexon shenjat e brendshme të tekstit letrar, aq më pak ku këto shenja janë derivat i mitit, e që dalin tani në shkrimin personal, siç është rasti të Koliqit. Kërkimi i shenjave të brendshme në shtatë novelat e Koliqit, te studimi i Çitakut, bëhen interpretim e aplikim. Vija personale e shkrimit të Koliqit nuk shmanget përgjatë ecurisë së



Ernest Koliqi

kërkimit e të teorizimit të këtyre shenjave. Semantikën e kërkimit, përgjatë shtatë novelave të Koliqit, e japin vetë esencat e leximit të shenjave. Studiuesi Çitaku, duke i lexuar shenjat, i lexon edhe shtatë variantet e novelave – shtatë kërkime të identitetit koliqian.

Identiteti personal

Pra, variantet lexohen nëpërmjet simbolikës-figurshmërisë së tekstit-novelave. Prandaj, mund të hetohet se

është edhe një hetim e analizim, gjithnjë mbi simbolikën e shkrimit të novelave, novela nëpër të cilat Koliqi kërkon identitetin personal. Kërkimi i identitetit personal të Koliqit, tani te Çitaku, bëhet provë identifikimi, tani në kërkimin e shtatë novelave. Hetimi i identitetit të Koliqit bëhet fenomen, gjithnjë duke pasur parasysh idetë e tekstit. Çitaku e veneron, e identifikon përgjatë strukturimit të shkrimit, duke gjetur edhe anën tragjike të kërkimit të identitetit të Koliqit; "Tragjika është e madhe me kërkimet e mëparshme në lashtësi, kjo sipas Koliqit, ka ndodhur për shkak të ndërrimit të pozicioneve të kërkimit, i cili i ka dërguar kërkimet e identitetit rrugëve të tjera". Andaj, filozofia e kërkimit bëhet mjeshtërisht, me një model të pëlqyeshëm hetimi e analizimi. Hyrja në shenjat e novelave, argumentohet dukshëm. Pra, nuk shtrihen hipoteza pa e pasur argumentimin. Shtrirja e ngadalshme në kërkim bëhet deri te hulumtimi i variacioneve tematike të novelave. Kodi tematik i novelave të Koliqit, për Çitakun, është gjithmonë i hapur. Kjo hapje kërkon thellimin e hulumtimit, duke qëndruar çdoherë larg evidencave historike. Thellimi e përshkrimi i të gjitha esencave të shkrimit të novelave bëhet shumëfish, nga një pozicion meditimi e reflektimi, siç pohon edhe vetë Çitaku kur hyn në strukturat e brendshme, për të hetuar lëvizshmërinë tematike të novelave.

Lëvizshmëria e kodit tematik të Koliqit ndodh në ikjen e së kaluarës, për t'u rikthyer në të tashmen personale, por çdoherë me kujtimin e përvojës së ikjes. Të gjitha këto, analizohen deri në detaje të imta përmes një sistemi të mundshëm letrar. Sistemi letrar bëhet komunikim më afër personale me tekstin, pra gjithnjë pranohet e analizohet vlëra. Kjo paraqet edhe një hetim të suksesshëm, sidomos kur kihet parasysh natyra e një studiuesi tanimë të modeluar e të strukturuar. ■



Qasje

Sa lexohet sot libri në Kosovë?

Naile DEMIRI

Librin nuk e zëvendëson asgjë. Leximi i romanit “Guximi për të shpresuar”, më bëri për një moment ngadhënjyese mbi të gjithë handikapët kulturoropolitikë që po manifestohen sot në teknika tjera të të nxënit. Lexuesi kosovar nuk e ka mundësinë e seleksionimit dhe përzgjedhjes të romanit më të mirë, pikërisht për çështje materiale. Romani “Guximi për të shpresuar” i Barack Obamas, përkthyer nga Diana Ndroqi-Dibra, i mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SH. B. A-së në Tiranë, shpërndahet falas, kurse tek ne në Kosovë shitet 10 Euro. Derisa jemi te faktori material, vlen të përmendet kontributi i psikologut Masllov, që në teorinë e tij për motivacionin, e vuri në spikamë këtë çështje, duke vërtetuar se njeriu njëherë plotëson nevojën për ushqim (nevojat fiziologjike), nevojën për siguri, nevojën për të jetuar në shoqëri, nevojën për prestigj, nevojën për vetaktualizim dhe të gjashtë radhit nevojën apo dëshirën për dituri. Ushqimi, siguria, nevoja për shoqëri të pastër janë sot tri shtylla që implikojnë, përkatësisht pengojnë, zhvillimin e motivit për të lexuar -motivin për dituri. Pjesa vitale e popullit të Kosovës sot është e re, por është e papunë. Dënimi më i madh për njeriun, për një fajtor, çfarëdo qoftë ai, kishte me qenë ta lësh pa punë. Me që është pa punë njeriu është edhe i pashpresë. Shumica e kësaj popullate jeton në varfëri të skajshme. Kohëve të fundit është në thellim e sipër

edhe një handikap kulturor-moral, si rezultat i diferencimit të shtresimit shoqëror në të pasur dhe në të varfër dhe i konkurrencës së madhe për punësim, ku në të shumtën e rasteve njerëzit punësohen sipas kriterit të shkathtësive të korruptimit, sesa sipas kriterit të diapazonit të diturive e shkathtësive profesionale. Po ashtu, edhe kjo stimulon lexuesin e rëndomtë.

Interneti nuk e ka zbuluar librin

Organizatorët e panairit të librit, vitin që lamë pas, nuk ishin të kënaqur me shitjen e librit. Ata deklaruan se shitja e librit ka rënë dukshëm këtë vit, për kundër asaj se ka pasur tituj të mirë e meritore dhe shumë më të pasur për nga stili dhe përmbajtja, në krahasim me herët e tjera. Por nga kjo deklaratë e libër-shitësve, nuk mundemi të nxjerrim konsekuencat, se libri lexohet apo nuk lexohet në Kosovë. Leximin e librit, në njëfarë mënyre, e ka zëvendësuar interneti dhe mediat e tjera elektronike, çka në të vërtetë, si të tilla edhe e dëmtojnë shëndetin fizik edhe stimulojnë tendencën drejt një hiçi intelektual dhe kulturor, përgjithësisht. Interneti si medium masiv nuk e zëvendëson librin. Në internet po na jepen thujse se të gjitha ato që po kemi nevojë: libra, filma, fotografi, peizazhe, ese, romane, e gjithçka tjetër, por asnjë nga këto nuk mund të thuhet se i përket një origjinali, një autoktonie që të shpien në mendimin kritik. Derisa nuk vërtetohet origjinaliteti i tyre, paraqitet dyshimi për falsifikimin e tyre. Në internet nuk e kemi një “censurë” të të dhënave shkencore, artistike,

filozofike, religjioze etj. Përkatësisht nuk e kemi një kritikë origjinaliteti të tyre, një vlerësim adekuat nga një autoritet me kompetencë, që mundëson zhvillimin analitik mendor të njëmendtë drejt atij burimi të dhënë. Këtë rol mund ta luajë vetëm e vetëm libri origjinal. Interneti nuk e ka zbuluar librin, por libri e ka zbuluar internetin. Interneti dhe mjetet si ai, janë edhe të papërshtatshëm edhe për çështje shëndetësore, për zhvillimin fizik në veçanti te adoleshentët dhe moshat e tjera të reja. Rrezatimi që lirohet nga energjia elektrike (nukleare) përcillet në sistemin nervor qendror përkatësisht në qendrat e të menduarit dhe në sistemin nervor sinoptik në përgjithësi, që shkakton tendencën për ngarkim me energji të tepruar dhe që shpien në djegien e qelizave që nuk mund ta bartin këtë energji. Tani shkencëtarët e fushave të ndryshme si, të fizikës nukleare, biopsikologjisë, neuropsikologjisë, biokimisë, kimisë organike etj, e kanë hetuar këtë tendencë negative të internetit dhe instrumenteve të ngjashme si ai dhe kanë filluar hulumtime që të gjenden mekanizma për të shpëtuar sa është e mundur shëndetin e njeriut sot e nesër. Pra ata kanë filluar të mendojnë për fëmijët e tyre.

Virusit e depërtuara në mjete të ndryshme elektrike, nuk kanë të bëjnë vetëm me instrumentin, por edhe me trurin e atij që është pranë atij instrumenti. Andaj shpëtojini fëmijët duke iu afruar librin, ngase në libër është mendimi origjinal, kritika, vlerësimi dhe mbi të gjitha shëndeti dhe pastërtia shpirtërore e kulturore, përgjithësisht. ■

Lajme nga kultura

Arbër Hadri drejton Muzeun e Kosovës

Arbër Hadri është zgjedhur drejtor i Muzeut të Kosovës, pasi që ka mundur kundërshtarët e tij që kanë konkurruar për këtë post. Kështu kanë bërë të ditur zyrtarë të Ministrisë së Kulturës, sipas të cilëve kontrata e Hadrit do të jetë për 3 muaj, me mundësi vazhdimi pas një vlerësimi për punën e tij në 1 ose 3 vite, apo në rast tjetër edhe ndërprerjen e kontratës. Historiani Arbër Hadri ka pasur kundër kandidat për këtë post Xhevdet Zekajn, Sadik Krasniqin, Kemajl Lucin dhe Fuad Islamit, të cilët kanë marrë më pak pikë gjatë vlerësimit që është bërë nga një juri e ministrisë.

Thelohet bashkëpunimi mes teatrove të Kosovës dhe Shqipërisë

Në Teatrin Kombëtar të Kosovës janë shfaqur disa filma dhe filmime të shumë viteve më parë, në një formë retrospektive, që do të sjellin momente të rëndësishme për kulturën shqiptare. Sipas drejtuesve të TK-së, do të jepen filma dokumentarë dhe kronika, me temë marrëdhëniet kulturore mes Shqipërisë dhe Kosovës në vitet e 70-ta. Ndër filmat që do të shfaqen është edhe shfaqja "Ervehe", me regji të Muharrem Qenës, një shfaqje me shumë shpërblime të kohës. Aktiviteti "Pranvera shqiptare" është në kuadër të muajit të kulturës Kosovë-Shqipëri dhe realizohet në bashkëpunim me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit. Bashkëpunimet ndërkulturore mes teatrove të qendrave shqiptare kanë filluar edhe në praktikë, kur muajin e kaluar, Teatri Shqiptar i Shkupit dha në Prishtinë shfaqjen "Net Shqiptare". Artistët kosovarë prezantuan atje shfaqjen "Tartufi". Gjithashtu, ekipi kosovar do të udhëtojë për në Tiranë më 13 mars, ku më 14 e 15 mars do të japë shfaqjen "Tartufi". Ndërsa Teatri kombëtar i Tiranës do të vijë në Kosovë më 6 prill, ku do të japë shfaqjen "Alegreto Albania".

Baleti i Kosovës prezantohet në festivalin "Dance Fest"

Baleti i Kosovës do të marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Shkupit "Dance Fest", që mbahet nga 7 deri më 16 prill, ku do të marrin pjesë trupa të baletëve nga vende të ndryshme të botës. Në këtë festival, Baleti i Kosovës do të prezantohet me shfaqjen "Performancë" të koreografit nga Shqipëria, Gjergj Prevazi. Sipas drejtuesve të Baletit të Kosovës, ftesa dhe prezantimi i Baletit të Kosovës për një festival të tillë është një mundësi e mirë për të shpalosur vlerat e artit kosovar dhe një rast i mirë për të afirmuar shtetësinë e shtetit tonë.

"Gjenerali i Ushtrisë së vdekur" edhe në gjuhën rome

Romani më i njohur në letërsinë shqipe dhe më i përkthyeri deri tash në gjuhët e huaja, i shkrimtarit tonë të njohur Ismail Kadare, "Gjenerali i Ushtrisë së vdekur", është përkthyer në gjuhën rome në Kosovë nga Ibrahim Elshani. Në gjuhën rome ky libër titullohet "Mula armadako generalo". Botimi i librit është mbështetur nga Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, ndërsa projektin për përkthimin e tij e ka mbështetur financiarisht Ambasada Zvicerane në Kosovë dhe Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Ibrahim Elshani, përkthyesi i këtij romani në gjuhën rome, ka thënë se të shkruarit në gjuhën rome është shumë i vështirë, për arsye se kjo gjuhë është shumë e varfër dhe e pazhvilluar. Shefi i Këshillit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Prishtinë, Bashkim Hisari, është shprehur se me këtë përkthim tregohet përpjekja maksimale për të përmbushur të drejtat e njeriut.

"Shota" performon në Austri

Ansambli i Këngëve dhe Valleve të Kosovës "Shota", do të performojë së shpejti në një turne në Austri, që mendohet se do të jetë një performim i realizuar në mënyrën më të mirë. Ky turne do të realizohet në këtë muaj dhe Ansambli "Shota" do të shfaqë tri koncerte, në tri qytetet më të mëdha të këtij shteti. Sipas drejtuesve të ansamblit, më 20 mars, ansambli do të shfaqë koncert para artdashësve në Vjenë, ndërsa më 21 dhe 22 Ansambli "Shota" do të shfaqë koncert në Linc dhe Gracë. Mësohet se drejtuesit e ansamblit janë në përpjekje që të organizojnë edhe një turne në Kroaci gjatë këtij viti.

IAP ka arritur numër rekord botimesh në vitin 2008

Instituti Albanologjik i Prishtinës ka promovuar veprimtarinë botuese vjetore për vitin 2008. Sipas drejtuesve të këtij instituti, për këtë vit, IAP, edhe për kundër shumë vështirësive, ka arritur të nxjerrë 23 vepra të autorëve të ndryshëm, duke përfshirë të gjitha fushat e shkencës së albanologjisë. Gjatë këtij viti, IAP-i ka nxjerrë një numër rekord prej 23 vepra me vëllime, revista, monografi, përmbledhje me punime studimore, dokumente e materiale të tjera albanologjike. Gjatë prezantimit të punës njëvjeçare të IAP-it, është vlerësuar se viti 2008 ka qenë një vit i mbarë dhe produktiv për IPA-in. Sipas drejtuesve të IAP-it, gjatë vitit që lamë pas, përveç veprimtarisë botuese, ky institut ka punuar edhe për realizimin e 49 projekteve të ndryshme: promovime të veprave të autorëve të ndryshëm, sesione, tryeza e konferenca të ndryshme shkencore. Po ashtu, janë realizuar edhe bashkëpunime të ndryshme nga ana e punëtorëve të IAP-it në arenën ndërkombëtare. ■

Esat Vatovci



Një fije jetë nëpër dhëmbë

Tahir FONIQI

ATDHEU

Atdheu njihet me këmbë jo me ëndrra
Ai nuk fillon nga asgjëja
Shtrihet prej zemrës në zemër
Për të gjithmonë mbetet diçka e pathënë
Atdheu nuk ikën nga vetvetja s'di të plakët
Mrrolet kur i numëron gjymtyrët e humbura
Trandet kur zihet keq me djallin nuk fle
Çan gurin bjeshkën malin kur e zë kolla
Mbyll deriçkat me muzgun e parë derën e lë hapur
Unë e di ç'lë ai në harresë ç'ruan në kujtime
E di si bëhet i paqenë si e zë gjëma
Si qëndron pip në këmbë e di
Unë e di si mbijeton i qetë si bëhet unë e di.

NË UDHËKRYQ

Jam në udhëkryq
Drithërimë
Rrathë që humbasin
Dritë e ndezur e fikur
E ha veten
Tek e shikoj qiellin
I bie tejpertej qytetit
Fillikat
Mbyll sytë veshët
Hesht
Kujt t'i qahem



PA TITULL

Erdha
Pashë tmerrin e botës
Një fije jetë nëpër dhëmbë
Dita gjak pikon

Kam parë si mbijeton dhëmbi i bardhë
E si bie bie dhëmbi i zi
Le të bjerë dhëmbi i zi
Le të bjerë
Le të bjerë
Ika pa lamtumirë

BALLKANI

Këmbëkryq në udhëkryq
Zgjohej e zë gjumi

Kokën gjok
Mendjen zog

Para ec
Një dy tre
Para ec

ODE PAQES

Vizatoje një qytet të lashtë
Një portë të madhe një bulevard
Një lumë një emër
Të salutosh tek bie e zgjohesh
Tek bën gjumë
Bari të mos digjet gjethet e verdha
Drurët të qëndrojnë vertikalisht

Vitrina e librit

Ibrahim Skenderi

"Burri në pikturë"

Poeti i njohur për fëmijë, Ibrahim Skenderi, këto ditë lexuesve të vegjël u dhuroj edhe një libër (pjesë teatrale për fëmijë) të titulluar "Burri në pikturë". Libri i takon zhanrit të dramës-njëaktëshe me një shumësi personazhesh. Në rolin e personazheve të veprës defilojnë gjashtë nxënës dhe nxënëse me emra simbolikë, profesori i historisë dhe piktori. Recensuesi i këtij libri Rexhep Smajlaj thotë se vepra ka karakter njohës dhe edukativ në të cilën synohet që në mënyrë të përshtatshme të artikulohej e njohura drejt të së panjohurës, duke u përplotësuar fjala me pikturën, në mënyrë që t'i njohë fëmijët me ngjarjet nga më të mëdhatë të historisë sonë kombëtare, pikërisht me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe personalitetin qendror të saj Ymer Prizrenin. Gjuha e përdorur në këtë libër është e rrjedhshme, e pastër dhe e kuptueshme. Libri ka 31 faqe. E botoi "Lidhja e shkrimtarëve e Kosovës"-dega Prizren, 2009



Avni Biqkaj

"Dasma e lirisë"

"Dasma e lirisë", e krijuar nga Avni Biqkaj, që njëkohësisht është edhe libri i dytë i botuar i këtij autori, përmban shkrime të cilat janë shkruar në ditën e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008. Proza "Udhëpërshkrimi i pavarësisë", pastaj "Cikli poetik për pavarësinë", dhe "Cikli i mesazheve të pavarësisë", të cilat edhe e përbëjnë librin "Dasma e pavarësisë", sjellin para lexuesve atmosferën dhe ngjarjet që kanë ndodhur në ditën e pavarësisë, ku autori, si pjesëmarrës i këtyre ngjarjeve, është frymëzuar për të bërë këtë libër. Libri ka 62 faqe. E botoi SHB "Art Muza". Prishtinë, 2009.



Besa GASHI

Nga kush po keqpërdoret gjuha shqipe?

“Zot! Jepu shqiptarëve vullnet dhe logjikë që të flasin shqip, të paktën kur janë në Shqipëri. Se, siç kanë zënë disa, shpejt a vonë, do ta bëjnë atdheun babiloni gjuhësh, ku s’do ta marrë vesh qeni të zonë.” (N. Bulka)

Halil ASLLANI

Eshtë plotësisht e kuptueshme që gjuha shqipe, si kurse edhe shumë gjuhë të tjera në botë, të huazojë fjalë të reja të cilat nuk ekzistojnë në fjalorin e saj dhe, më pas, ato fjalë t’i përshtatë duke u dhënë tipare gramatikore që janë në pajtim me rregullat e saj. Pa dyshim se edhe gjuha shqipe duhet të tregojë aftësitë e saj dhe të pranojë ne gjirin e saj fjalë të reja, të cilat po lindin si pasojë e zhvillimeve dhe zbulimeve të shumta në fusha të ndryshme shoqërore. Kjo nënkupton se gjuha nuk është statike. Ajo ndryshon dhe zhvillohet njëkohësisht me ndryshimet dhe zhvillimet të cilat ndodhin në shoqëri. Kur dy a po më shumë gjuhë kanë kontakt të drejtpërdrejtë, patjetër do të kenë ndikim tek njëra-tjetra në rrafshet e ndryshme gjuhësore. Por, duhet të ekzistojnë edhe ligjet dhe institucionet përkatëse të cilat merren me çështjen e gjuhës.

Gjuhën po e bastardojnë politikanët, mediat... madje edhe profesorët

Mirëpo një gjë është shumë e pakuptueshme dhe e patolerueshme. E kjo është përdorimi i barbarizmave (fjalëve apo shprehjeve të huazuara, pa nevojë, nga një gjuhë tjetër) të ndryshëm, në vend të fjalëve të bukura dhe të ëmbla shqipe. Këto lloj barbarizmash i hasim, në jetën e përditshme, tek ata nga të cilët pritet më së paku. E këta janë udhëheqësit më të lartë shtetërorë, pra, parlamenti, qeveria, mediat e shkruara e elektronike etj. Me të vërtetë, këta njerëz dhe këto institucione, po ta dinin vlerën dhe rëndësinë e gjuhës nuk do të bënin shkelje të tilla. Këta njerëz përdorin barbarizma në mënyrë që të tregojnë arsimim dhe kulturë të një niveli më të lartë dhe kështu të tingëllojnë tek shqipfolësit e rëndomtë si njerëz të dijsëm kur përdorin terma të cilat nuk i përkasin gjuhës shqipe.

Fakt tjetër shqetësues është përdorimi i barbarizmave të tillë nga profesorët universitarë, të cilët nëpër ligjëratat e tyre përdorin shumë fjalë të tilla që nuk kanë të bëjnë me gjuhën shqipe.

Në vijim po jap disa thënie për gjuhën nga figura të ndritshme të kombit tonë. Thënie kuptimplota nga ata të cilët kanë kontribuar që gjuha shqipe, si njëra ndër gjuhët më të vjetra në botë, të ruajë mëvetësinë dhe origjinalitetin e saj ndër shekuj, gjuhë e cila gjithmonë ka lënë përshtypje të madhe dhe ka ngjallur interes të madh tek të tjerët, gjuhë që ka një jehonë të gjerë, pra, një gjuhë e bujshme me plot kuptimin e fjalës.

“Themelin e diturisë dhe të atdhetarisë e përbën gjuha shqipe.”
Mit’hat Frashëri.

“Fjala e huaj në gjuhë është si dhia ndër dhen.”

N. Frashëri.

“Gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar.”

E. Çabej.

“Gjuha pasqyron një kombësi. Ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit të kësaj kulture.”

E. Çabej.

Ja një listë e disa fjalëve jo shqipe, të cilat i kam hasur tek disa profesorë dhe tek mediat e shkruara dhe ato elektronike, pra, fjalë të cilat nuk ekzistojnë në fjalorin e gjuhës shqipe.

Barbarizma (fjala e huazuar)

Fjala në shqip

Barrierë	Pengesë
Diskurs	Fjalim, ligjëratë
Ekspansion	Zgjerim
Eksperiencë	Përvojë
Fleksibilitet	Lakueshmëri
Fundamental	Kryesor, themelor
Hendikep	Pengesë, e metë
Imediat	I menjëhershëm
Interaktiv	Bashkëveprues
Invadim	Pushtim
Invazion	Pushtim
Investigim	Hulumtim, hetim
Involvim	Përfshirje
Koincidençë	Rastësi
Konfident	I sigurt, me besim në vete
Kontinuitet	Vazhdimësi
Koshiencë	Vetëdije, ndërgjegje
Kreativ	Krijues
Kualitet	Cilësi
Kuantitet	Sasi
Luku	Pamja, dukja
Narracion	Kallëzim, tregim, rrëfim
Perfekt	I përkryer, i përsosur
Selektim	Përzgjedhje
Stopim	Ndalje
Verdikt	Vendim
Vokabular	Fjalor

Mendoj se është koha dhe momenti i duhur që populli shqiptar të tregojë një pjekuri dhe maturi të paktën në përdorimin e gjuhës si elementi më i rëndësishëm i një kombi, si një element që tregon kulturë, traditë dhe identitet. Tek e fundit, një komb nuk shuhet nëse humb një luftë. Një komb humb dhe shuhet nëse humb gjuhën. Këtë mund ta vërtetojë edhe thënia e E. Çabejt: “Gjuha pasqyron një kombësi. Ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj.”

Një udhëtim për festa në Gjermani

Tri ditë të paharruara feste

“Derisa ti flet shqip dhe derisa do të rrëfesh historinë e kombit tënd, brez pas brezi, ti gjithmonë do të quhesh e do të mbetesh shqiptar.”



Valentina GARA

Marsi i një viti shqiptar nuk është një muaj i zakonshëm i një viti. Ky muaj i një stine të re, i një viti të ri, i një dekade, i një shekulli të ri, e që më tej do të vazhdojë me shekuj, është i veçantë për çdo njeri që merr frymë, që flet e këndon shqip dhe që kudo në botë ka lindur shqiptar. Në atdhe nuk harrohen kurrë dëshmorët, liridashësit, nuk harrohet lavdia e krenaria e atyre që sot nuk janë më, e atyre që ngritën zërin kundër dhunës, që hapën gjoksin para pushkës së armikut. Këta dëshmorë nuk harrohen as edhe në fund të botës, sepse historinë shqiptare e përcollën për shumë breza edhe në mërgim.

Kënga shqipe në dhé të huaj

Erdha më 21 shkurt nga Kosova, vetëm katër ditë pas një feste të madhe në atdhe me rastin e Pavarësisë, për të marrë pjesë në festën tjetër po aq të madhërisht si ajo që lash pas në atdhe, por kjo festë tani festohej nga shoqata “Iliria” në qytetin e Heidelbergut. Më pas, më 6 mars, në Shwetzingen, nga shkolla shqipe u mbajt manifestimi për ngjarjet historike të shkurtit dhe marsit, shkollë të cilën e themeloi dhe akoma e mban gjallë mësuesja e gjuhës shqipe, Shqipe Gara - Berisha me përkrahjen e të gjithë prindërve dhe shoqatës. Më 7 mars, në Heidelberg, u mbajt manifestimi për ditën e dëshmorëve, e organizuar përsëri nga shoqata “Iliria”.

Tri ditë festimi! Kisha një nder të madh që të isha pjesëmarrëse në këto manifestime atdhedashëse. Në dhé të huaj, në një vend ku rrethohesh nga një gjuhë që tingëllon ndryshe nga ajo që dëgjojmë që nga fëmijëria, është krenari të dëgjosh duke kënduar e recituar shqip.

Kisha dëgjuar himnin kombëtar në atdhe, por të dëgjosh himnin e kombit tënd në një vend kaq të largët, ku këndohet me një permallim, me një dëshirë, me një zjarr lirie që vlon nga zemrat e të vegjëlve, është një ndjenjë që nuk të lejon dot të përmbahesh nga lotët.

I mban gjallë shpresa se një ditë do të kthehen në atdhe Aq të vegjël ishin ata fëmijë, aq të mëdhenj dukeshin! Madhështinë e tyre e shtonte edhe veshja kombëtare që mbanin të veshur të gjithë fëmijët në skenë, gjatë recitimeve, gjatë valleve e gjatë këngëve të bukura shqipe.

Një vogëlushe, që quhej Albina dhe ishte diku rreth 4 vjeçare, akoma nuk mund të shqiptonte fjalët mirë, por me atë qëndrim i thoshte vargjet shqipe me aq forcë, sikur donte të tregonte me tërë zemrën e saj të vogël dashurinë e madhe që kishte për atdheun. E si të mos e ndieja edhe unë këtë dashuri?! “O vendi im” ishte kënga që u këndua nga tre fëmijët, Brikenë, Bledar e Blegin, por do të doja ta dëgjoja këtë këngë në malet e Sharrit, ashtu siç e këndonin ata “Sharr babai im” dhe të zgjoja çdo shqisë timen e me tërë fuqinë e zërit tim të këndoja me ta, e të qaja me ta. Pastaj të pushoja e të dëgjoja vargjet e bukura të recituara nga Liria, emri i së cilës tregon se liria ishte ajo që e donin edhe prindërit e saj, si çdo shqiptar tjetër atje në mërgim, e më pas të vallëzoja në vallen e bukur me fëmijët e shoqatës “Drita” që kishin udhëtuar me kilometra nga Zvicra për të sjellë ngrohtësinë e valles shqiptare. Po edhe sikur të kisha sytë e mbyllur do të më zgjonte zëri i Blertës, që me çdo fjalë mburrej që ishte një vajzë shqiptare.

Unë e pikëlluar dëgjoja me vëmendje, sepse edhe këta fëmijë meritonin të ishin në vatrat e tyre, aty ku gjyshërit e tyre do t’i përkëdhelnin, ku edhe dielli do t’i ngrohte më shumë, ku edhe hëna do t’i ndriçonte më mirë, atje ku edhe tingujt e zogjve kanë melodinë e këngës shqipe.

Nuk ka dritare të thyera në histori, kur atë histori e kanë ndërtuar zemrat e thyera të familjeve që janë ndarë para shumë kohësh, para shumë viteve. Këta mërgimtarë i mban gjithmonë gjallë shpresa se një ditë do të kthehen në atdhe e të shijojnë jetën në Kosovën e lirë. Askush nuk mund t’i kuptojë po s’e kuptoi mallin e tyre, askush s’mund të ndiejë dhimbjen po s’e kuptoi një mërgimtar të tretur larg.

Po e përmbylli këtë shkrim me vargjet:

“Nëse ti më quan lypës ke të drejtë,
edhe nëse nuk shtrij dorën për një kafshatë këtu n’mërgim,
por nëse ti më quan mbret këtu, gabon shumë
se unë jam mbret vetëm në atdheun tim.” ■



Kritja e temperaturave globale po i shter burimet e ujit të pijshëm

Studimet tregojnë se deri më 2050, për rreth 6 miliardë banorë të botës, gjetja e ujit të pijshëm do të jetë një sfidë e madhe (parashihet që një person të ketë në dispozicion rreth 100 metra kub në vit).



Genta HOXHA

Shkencëtarët, që studiojnë zhvillimin njerëzor, thonë se secilit person i duhen mesatarisht 20 litra ujë në ditë. Kjo sasi është e domosdoshme për nevoja elementare, për pirje, zierje dhe larje, për ta larguar bartjen e sëmundjeve të ndryshme. Por në kohën e thatësisë së madhe në Afrikën Lindore, njerëzit kishin mesatarisht pesë litra ujë në ditë, madje në disa raste jugafrikanët kishin vetëm nga një litër ujë në ditë, apo tri gota.

Kjo mungesë e ujit në Afrikën Lindore tregon se kjo "recetë" nuk është e mjaftueshme që një komb të marrë rrugën e zhvillimit dhe të jetë në hap me vendet e përparuara.

Mungesa e ujit shkakton ngecje shoqërore

"Natyrisht se ka shumë nevoja elementare që janë të rëndësishme për zhvillimin e njeriut" - vlerëson eksperti i Kombeve të Bashkuara, Andrew Hud-

Bota po ballafaq

son - "por uji është më i rëndësishmi".

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ku punon edhe eksperti Hudson, ka vlerësuar pas një studimi se uji është njëri prej faktorëve kryesorë për zhvillimin dhe shëndetin e një kombi. Ai ka bërë studime në kuadër të programit Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, i njohur ndërkombëtarisht si HDI.

"Kemi bërë hulumtime për qasjen në energji elektrike, sistemin shëndetësor, shpenzim të edukimit, por kemi kuptuar se uji i pijshëm është faktori kryesor që e mban njeriun të shëndetshëm" - ka deklaruar Hudson.

Deklaratat e tij ngrënë dy çështje me të cilat duhet të merren ekspertët e ujit. Pse atëherë disa bashkësi kanë aq pak qasje në ujë të pijshëm? Çfarë do të jetë pasqyra e njerëzimit në kohën kur popullsia e botës po rritet gjithnjë e më shumë, qytetet industriale po shtohen dhe po kemi thirrje alarmante për shkak të ndryshimeve klimatike, si pasojë e rritjes së temperaturave të botës?

Në raportin e OKB-së për ujin thuhet se "mungesa e ujit të pijshëm për disa shtete është një shqetësim i madh". Më tej në raport është theksuar se "mungesa e ujit nuk vjen për shkak të paaftësisë fizike të njerëzimit, por për shkak të varfërisë, pafuqisë dhe jobarazisë njerëzore".

Edhe statistikat e OKB-së përkrahin përfundimin e ekspertëve hartues të raportit. Në Japoni dhe Kamboxhia ka të reshura pothuajse të barabarta vjetore - rreth 160 cm për vit.

Por derisa një japonez ka komoditetin të ketë në dispozicion rreth 400 litra ujë në ditë, një kamboxhian nuk mund të llogarisë më shumë se sa një e dhjeta e sasisë së përdorur nga një japonez. Krahasuar me statistikat e vitit 1990, numri i personave që kanë qasje në ujë të pijshëm është rritur për një 1,6 miliardë banorë.

Por, derisa popullsia e botës po rritet, po ka edhe ndryshime të mëdha klimatike që e vështirësojnë gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm. Njohësit e rrjedhave klimatike paralajmërojnë se në disa vende të botës, në të ardhmen, do të ketë një gjendje të rëndë furnizimi me ujë.

Keqpërdorimi i ujit

"Ka shumë lumenj të cilët nuk po arrijnë të derdhen në dete" - thekson Mark Smith, drejtues i Bashkimit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN). "Lumi i Verdhë është vetëm njëri prej tyre" - alarmon ai.

"Deti Aral dhe Liqeni i Çadit kanë pësuar rënie të nivelit të ujit për shkak se shumë lumenj që derdheshin në ta, janë shterur. Ju mund të shihni se edhe disa burime të tjera ujore në Tanzani, brenda gjysmës së vitit, mund të shterohen. Arsyeja kryesore pse do të ndodhë kjo është edhe fakti se banorët përreth tyre po i shfrytëzojnë këto burime për ujitjen e fushave me misër".

Gjatë vitit të kaluar, Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike (IPCC) ka bërë një studim, se cili mund të jetë ndikimi i ndryshimeve klimatike në qasjen e furnizimit të njerëzve me ujë të pijshëm. Pas një studimi që kanë bërë për fabrikat e shumta të ujit nëpër botë, ata kanë thënë se sa më të larta që do të jenë temperaturat globale, më i lagësht do të jetë uji, por nuk dihet ende se në çfarë kohe dhe në çfarë vendi do të mblidhet uji.



ohet me mungesën e ujit

“Në përgjithësi, ne shohim se thatësi po kemi në vende nëntropikale, nga Evropa Jugore deri në Kazakistan dhe nga Afrika Veriore deri në Iran” - parashikon Martin Parry, i cili është njëri prej drejtuesve të IPCC-së. “Thatësia do të shtohet edhe në Amerikën Qendrore. Ekuivalente të ngjashme do të ketë edhe në Afrikën Jugore dhe në Australi”.

Industria gllabëruese

Parry ka tërhequr vërejtjen se në vend të Afrikës Veriore dhe Azisë Qendrore, njerëzit do ta kenë të vështirë të kenë mundësinë të pinë edhe vetëm një gotë ujë. Por në disa vende pritet të ketë rritje të reshjeve të shiut.

“Nëse e shikoni Indinë, Birmaninë dhe Bangladeshin, ka shumë indikacione se do të ketë rritje në qasje të ujit të pijshëm” - thotë Parry. Por ai paralajmëron edhe mundësinë e zgjatjes së kohës së mungesës së monsuneve, reshjeve sezonale të shiut, të cilat janë jetike për Gadishullin Indian.

Por edhe rritja e numrit të banorëve të botës – rreth 2,5 miliardë njerëz më shumë, deri më 2050 – do të sjellë telashe të mëdha për gjetjen e burimeve të ujit të pijshëm në tokë. Dhe derisa po kemi gjithnjë e më shumë thatësi, do të ketë vështirësi të mëdha që këta ekstra banorë të kenë ujë të mjaftueshëm për pije, zierje dhe larje.

Një shqetësim tjetër që kanë ngritur ekspertët është edhe fakti se industria po shfrytëzon gjithnjë e më shumë ujin

shumë të nevojshëm për gojën e njeriut. Hulumtuesit e Universitetit gjerman të Kasselit, të drejtuar nga Martina Floerke, kanë thënë se ndryshimi klimatik do të ketë ndikim të madh në thellimin e krizës së ujit të pijshëm.

“Shkaku kryesor i rritjes së mungesës së ujit do të jetë i lidhur me rritjen e temperaturave globale” - ka theksuar ekipi i ekspertëve gjermanë. Studimet tregojnë se deri më 2050, për rreth 6 miliardë banorë të botës, gjetja e ujit të pijshëm do të jetë një sfidë e madhe (parashihet që një person të ketë në dispozicion rreth 100 metra kub në vit).

Ironia e fatit

Por në të gjitha studimet parashihet që shoqëritë e zhvilluara nuk do të kenë telashe të mëdha për përmirësimin e gjendjes, ndërsa shoqërive më të varfra të planetit nuk do t’iu hiqet “gazepi” edhe në të ardhmen.

Para një shekulli, Australia kishte ndërtuar një linjë prej pesëqind kilometrash për bartjen e ujit të pijshëm nga pjesa perëndimore në zemër të kontinentit, ku ishte e përqendruar industria dhe popullata. Tani edhe Peth bregdetar ka mungesë të ujit dhe autoritetet kanë filluar të flasin për mundësinë e një gypi më të gjatë transportues të ujit nga pjesa veriore e Australisë.

Edhe shumë shtete të Lindjes së Mesme po shqyrtojnë mundësinë e ndërtimit të linjave transportuese të

ujit. Madje edhe Londra planifikon bartjen e ujit me gypa të linjave të gjata.

Kina po ua ndërron drejtimin shumë lumenjve, derisa Spanja dhe Qiproja bartin ujë edhe me anije transportuese. Por a mund që të gjitha shoqëritë ta kenë këtë “luks”? A do të mund, duke u bazuar në parashikimet e ekspertëve se deri më 2030 do të fillojnë të shkrihen shumë akullnaja të Himalajeve, të ndërtohen sistemi furnizimi me ujë të pijshëm për shoqëritë poshtë maleve të larta? Kjo është mundësi shumë e mirë, por ndërtimi i rezervuarëve në lartësi të tilla është i vështirë dhe shumë i kushtueshëm për shoqëritë e varfra.

“Por shoqëritë duhet të vendosin se cila do të jetë rruga më e mirë për ta zgjidhur çështjen e ujit të pijshëm” - thekson eksperti Mark Smith. Studiuesit thonë se shumë vende në zhvillim bëjnë projekte të atypëratyshme.

Edhe banorët e Amazonës kanë thënë se kanë mungesë të burimeve të ujit. Si është e mundur që në regjion të madh malor të ketë mungesë të reshjeve? Ekspertët kanë thënë se edhe në këtë zonë po pritet mali dhe po ndikon ndryshimi klimatik.

Pra, kur Amazona ndien këtë presion, është e vështirë të besohet se nëpër vendet e tjera do të kemi një pamje më të bukur, ku tashmë malet e tyre kanë ndryshuar ngjyrat, ndërkaq “fyti” i banorëve të tyre e di më së miri cila është pasoja e mungesës së ujit, derisa kërkesat për të po rriten. ■



Anemia

Ndër shenjat më të mundshme dhe më të zakonshme të anemisë mund të jenë: zbehja e lëkurës, skuqja jo normale e buzëve, irritabiliteti i rritur, lodhja e shpejtë fizike, marrje mendsh dhe takikardi (rrahje e shpejtë e zemrës).

**Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI**

Anemia mund të definohet si zvogëlim i numrit të eritrociteve, apo si zvogëlim i sasisë së hemoglobinës në njësinë e vëllimit të gjakut. E përkthyer në shqip, fjala anemi ka kuptim të pagjakësisë, term ky që nuk ngërthen në vete të gjitha çrregullimet që japin aneminë. Çrregullimet që ndodhin në anemi janë pasojë e oksigjenimit të zvogëluar të indeve, kurse sasia e oksigjenit të bartur varet drejtpërdrejt nga sasia dhe forma e hemoglobinës si proteinë përbërëse e eritrociteve-qelizave të kuqe të gjakut. Definicioni i dytë është më i saktë për nga aspekti funksional, sepse jo çdo herë kemi gjakderdhje tek anemia dhe se numri i eritrociteve nuk është masë plotësisht e saktë për aneminë. Ato mund të përmbajnë sasi të zvogëluar të hemoglobinës dhe, edhe përkundrazi numrit të tyre normal, sasia e oksigjenit të transportuar përmes tyre të jetë e zvogëluar.

Shkaktarët e anemisë janë të shumtë dhe të llojllojshëm por edhe kriteret e klasifikimit të anemive janë të ndryshme. Anemitë në bazë të shkaktarit etiologjik mund të klasifikohen si më poshtë:

- *Anemia nga prodhimi dhe regjenerimi i pamjaftueshëm i eritrociteve,*
- *Anemia sideropenike,*

- *Talasemitë,*
- *Anemiti për shkak të zbërthimit të shtuar të eritrociteve,*
- *Anemia nga gjakderdhjet e ndryshme,*
- *Anemia nga çrregullimet e trashëguara,*
- *Anemia nga kequshqyerja,*
- *Anemia nga infeksionet e ndryshme,*
- *Anemia nga ekspozimi ndaj disa medikamenteve helmuese,*
- *Anemia nga prezenca e disa kacereve, etj.*

Anemia hemolitike

Anemia nga shkatërrimi i tejskajshëm i eritrociteve, që ndryshe quhet edhe anemia hemolitike, vjen si rezultat i shkatërrimit të parakohshëm të rruazave të kuqe të gjakut, jetëgjatësia e të cilave shkon deri në 120 ditë. Gjatë kësaj sëmundje kjo jetëgjatësi shkurtohet deri në 25 % të jetëgjatësisë normale. Në këtë rast, indi gjakformues nuk është në gjendje që të plotësojë nevojat e organizmit për rruazat e kuqe të gjakut, pra eritrocitet. Ky lloj i anemisë mund të jetë edhe i trashëguar në formën e disa çrregullimeve kom-

Për t'i ndihmuar personat me anemi, mund të dhurojmë gjak. Femrat mund të dhurojnë gjak çdo katër muaj, ndërsa meshkujt mund të dhurojnë gjak çdo tre muaj.

plekse siç janë: Sickle Cell Anemia; Talasemia; Mungesa e enzimës të quajtur G6PDHG (Glukozë-6-Fosfat-Dihidrogjenazë).

Anemia e shkaktuar nga humbja e rruazave të kuqe të gjakut

Kjo lloj anemie mund të shkaktohet nga humbja e madhe e gjakut si pasojë e një lëndimi, operacioni, apo edhe moskoagulimit të rregullt të gjakut. Kjo ndodh ngase, menjëherë pas gjakderdhjes, numri i eritrociteve dhe përqendrimi i hemoglobinës në njësi të vëllimit të gjakut bie. Organizmi reagon ndaj një gjendjeje të krijuar, duke e iniciuar procesin eritrocitformues përafërsisht gjashtë orë pas gjakderdhjes.


Anemia e shkaktuar nga prodhimi i pamjaftueshëm i rruazave të kuqe të gjakut

Kjo lloj anemie vjen si shkak i paqëndrueshmërisë së indit gjakformues në prodhimin e mjaftueshëm të rruazave të kuqe të gjakut, në mënyrë që të plotësojë nevojat e indeve të organizmit. Kjo mund të vijë si rezultat i pranisë së disa lloj kacereve në organizmin e njeriut, por edhe nga sëmundje të ndryshme kronike.

Anemiti për shkak të çrregullimeve të sintezës dhe ndërtimit të hemoglobinës

Në këtë grup të anemive bëjnë pjesë një numër i madh sosh që kanë të bëjnë me përbërësit e hemoglobinës. Duhet





theksuar se vetëm në bazë të çrregulimeve të strukturës proteinike janë përshkruar 400 variante jo normale të hemoglobinës. Ne do t'i themi vetëm pak fjalë për një lloj të anemisë që bën pjesë në këtë grup dhe që na preokupon më shumë, pra ajo është anemia nga mungesa e hekurit.

Mungesa e hekurit është shkaku më i shpeshtë i anemisë dhe kjo vjen qoftë nga mos marrja e hekurit me ushqim, qoftë nga keqlidhja në molekulën e hemoglobinës, apo qoftë nga gjakderdhjet e ndryshme. Anemia nga mungesa e hekurit është më e shpeshtë tek femrat për shkak të menstruacioneve (që natyrisht shoqërohen me humbje gjaku - dhe me humbje hekurit). Në moshat e shtyra kjo lloj anemie, nga mungesa e hekurit, ka shumë mundësi të jetë pasojë e kancerit të kolonit, por jo çdo herë. Ndërsa vetëm tek fëmijët mundet që mungesa e hekurit të jetë pasojë e sasisë të pamjaftueshme të tij në dietë.

Shenjat dhe simptomat e anemisë

Ndër shenjat më të mundshme dhe më të zakonshme të anemisë mund të jenë, zbehja e lëkurës, skuqja jo normale e buzëve, irritabiliteti i rritur, lodhja e shpejtë fizike, marrje mendsh dhe takikardi (rrahje e shpejtë e zemrës). Ka edhe shenja e simptoma të tjera me të cilat merren dhe kujdesen punonjësit e klinikave gjatë punës së tyre profesionale.

Diagnostikimi i anemisë

Në shumicën e rasteve, diagnostikimi i kësaj sëmundje ndodh pasi të bëhen

një sërë testesh të përbërjes së gjakut, të cilat tregojnë përbërjen dhe strukturën e elementeve të gjakut. Biopsia e palcës të kockave është analiza më e besueshme për sasinë e hekurit në organizëm.

Trajtimi dhe shërimi i anemisë


Trajtimi varet direkt nga lloji dhe shkaku i anemisë. Zakonisht trajtimi fillon me ristrukturimin e niveleve të hekurit në gjak, acidit folik dhe vitaminës B12, që të gjitha këto komponentë të rëndësishëm të gjakut. Të sëmurëve me anemi u këshillohet përdorimi i frutave të freskëta që përmbajnë vitaminë C, e cila ndihmon në absorbimin e hekurit. Po ashtu, duhet të konsumojnë ushqime të shumëllojshme dhe të pasura me hekur, si mish, peshk, shpretkë, vezë, perime, fruta, etj.

Trajtimi klinik i disa llojeve të anemive bëhet me: Transfuzion të rru-

azave të kuqe të gjakut të marra nga një dhurues; heqje dhe transplantim të shpretkës (organit ku shkatërrohen qelizat e kuqe të gjakut) ose trajtimi me ilaçe që mbrojnë qarkullimin normal të rruazave të gjakut brenda sistemit të qarkullimit; trajtim me medikamente që luftojnë infeksione të ndryshme dhe që stimulojnë indin kockor në prodhimin më të madh sasior të këtyre rruazave; dhe trasplantim i indit gjakformues të palcës në rastet e formave malinje të anemisë.

Si t'i parandalojmë anemitë?

Parandalimi ose jo i anemisë varet drejtpërdrejt nga shkaktari i saj. Disa lloje mund t'i parandalojmë me një dietë efektive me vitaminë B12, acid folik e hekur. Të tjerat, me karakter trashëgues dhe të panjohur, na kufizohen vetëm t'i trajtojmë. ■



Sporti i Kosovës drejt ndërkombëtarizimit

A do të jetë viti 2009 fundi i

Me gjithë faktin se Kosova e shpalli pavarësinë e vet një vit më parë, sporti vazhdon të mbetet i izoluar, pasi kërkesat e shumta për anëtarësim në asociacione të ndryshme evropiane u refuzuan. Udhëheqësit e federatave ia hedhin fajin për këtë politikës, derisa besojnë se viti 2009 do të jetë vendimtar për pranimin e tyre në arenën ndërkombëtare



Alban BILALLI

Sporti i Kosovës, gjatë vitit të parë të pavarësisë së shtetit, u karakterizua me shumë probleme. Kushtet e vështira financiare, mungesa e stadioneve dhe palëstrave sportive ishin vetëm disa nga vështirësitë. Me gjithë këto vështirësi garat vazhduan. Për më tepër, krerët e sportit bënë përpjekje të vazhdueshme që të anëtarësohen në federatat ndërkombëtare të sportit.

Shpalljes së pavarësisë, krahas popullit, ju gëzuan në mënyrë të veçantë edhe krerët e federatave të sportit, të cilët e shtuan shpresën se ky vit do të jetë vit i fundit të vuajtjeve të tyre dhe viti i njohjes ndërkombëtare për sportin e Kosovës.

Fakti se Kosova ende nuk është anëtare e OKB-së përbën një handicap të madh në drejtim të njohjes dhe avancimit të sportit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një problem tjetër paraqet edhe Komiteti Olimpik i Kosovës, i cili ende nuk është i pranuar në familjen e madhe të sporteve të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Por kundërshtarët më të mëdhenj janë federatat serbe që po llojnë kundër pranimit të sportit të Kosovës në Federatat Ndërkombëtare. Kosova ka shumë të talentuar dhe të talentuara, të cilët janë dëshmuar në sporte të ndryshme. Sportistë kulmorë si Luan Krasniqi, Valon Behrami e shumë të tjerë, për fat të keq, zhvillojnë aktivitet sportiv nën flamurin dhe himnin e shteteve të tjera. Si pasojë e këtij mospranimit, shumë talente po shuhen.

Ndërkombëtarizimi i sportit ishte dhe është në agjendën e çdo federate. Le të shohim se si paraqitet gjendja në sportet kryesore të Kosovës:

Futbolli

Federata e Futbollit të Kosovës po bën çështje e mundur që të pranohet në Federatat Ndërkombëtare të Futbollit FIFA dhe UEFA. Shumë shkresa me vulë të FFK-s dhe të kryetarit të saj janë dërguar në adresë të këtyre dy shtëpive të futbollit. Por përgjigjja e tyre ishte se Kosova duhet së pari të pranohet si shtet ndërkombëtarisht, e më pas futbollit. Mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të FIFA-s, që u mbajt në Tokio të Japonisë më 19-20 dhjetor 2008, FFK-ja i dërgoi një shkresë ku i kërkoi KE të FIFA-s që Kosovës t'i lejohet së paku të zhvillojë ndeshje miqësore. Siç dihet, muaj më parë, FIFA ia ndaloi Përfaqësueses së Kosovës në Futboll të zhvillojë takime miqësore me Brazilin dhe Beninin. Komiteti Ekzekutiv i FIFA-s, kërkesën e FFK-s ia la për detyrë që ta shqyrtojë UEFA-s, e cila në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2009 nuk vendosi asgjë për Kosovën, duke e mbajtur kështu peng sportin më të dashur tek ne.



Basketbolli

Me të njëjtin problem si futbollit balafaqohet edhe basketbolli. Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Eroll Belegu dhe asociacioni që ai drejton, do të provojnë edhe gjatë vitit 2009 që të pranohen në Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit FIBA. FBK-ja, gjatë vitit 2008, kishte aplikuar dy herë për pranim në FIBA, por kërkesa e tyre ishte refuzuar. Duhet cekur se Federata e Basketbollit të Serbisë ka një ndikim të madh në FIBA dhe arsyet e refuzimit të kërkesës mund të jenë më shumë politike. Megjithëkëtë FBK-ja synon që në muajin maj, kur mbahet mbledhja e Bordit Qendror të FIBA-s, të tentojnë edhe një herë me kërkesën e tyre për pranim në këtë organizatë. FBK-ja do të kërkojë edhe ndihmën e qeverisë dhe të politikanëve për të ndikuar te vendet ku kemi miq, që federatat e tyre ta përkrahin kërkesën e FBK-s për pranim në FIBA.

Hendbolli

Federata e Hendbollit të Kosovës, me të drejta të kufizuara, është pranuar në Federatën Ndërkombëtare të Hendbollit më 18 dhjetor 2004, në Kongresin e 7-të të jashtëzakonshëm të mbajtur në Budapest. Tani, në vitin 2009, pret që të pranohet me të drejta të plota. Tani për tani FFH-ja, ka të drejtë të zhvillojë ndeshje vetëm me klubet e saj, por jo edhe me përfaqësuese. Me



i izolimit?

përfaqësuese ka të drejtë të zhvillojë vetëm ndeshje miqësore. FFH-ja nuk ka qëndruar duarkryq. Ajo ka zhvilluar ndeshje miqësore me Turqinë, Egjiptin etj. Kryetari i FFH-s, Mexhid Devaja dhe stafi i tij po llojnë nëpër vende të ndryshme që hendbolli i Kosovës të pranohet me të drejta të plota.

Sportet luftarake

Edhe sportet luftarake shpresojnë që sa më shpejt të pranohen ndërkombëtarisht dhe forcat e tyre t'i masin me sportistët e huaj.

Federata e Boksit të Kosovës, në shkurt të vitit 2009, priste nga Federata Ndërkombëtare e Boksit AIBA, që t'i pranojë nën ombrellën e saj. Kërkesa e Federatës së Boksit të Kosovës (FboxK) për anëtarësim në Federatën Botërore të Boksit Amator (AIBA) është refuzuar më 18 shkurt 2009. Ky vendim është marrë në Kongresin e AIBA-s, i cili është mbajtur në Milano të Italisë. Refuzimin e kërkesës e ka konfirmuar kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, i cili ka qenë i pranishëm në punimet e këtij Kongresi. Sipas Hasanit, AIBA ka dhënë dy arsye për refuzimin e kërkesës së drejtuesve të boksit të Kosovës për anëtarësim në këtë asociacion.

“Kërkesa e Federatës së Boksit është refuzuar me arsyetimin se Komiteti Olimpik i Kosovës ende nuk është i njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe se Kosova ende nuk është pjesë e OKB-së”.

Në anën tjetër, me të marrë vendimin edhe presidenti i AIBA-s, Ching-Kuo Wu, ka dërguar një letër në adresë të FboxK-së, ku ka treguar arsyet e refuzimit të kërkesës së tyre. “Si president i AIBA, ju informoj se gjatë mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të AIBA-s, më 16 shkurt në Milano, është vendosur të mos pranohet Federata e Boksit të Kosovës, për këto arsye: KOK nuk është i pranuar nga IOC dhe Kosova ende nuk është një shtet i pranuar nga Kombet e Bashkuara” - thuhet në këtë letër, një kopje e së cilës është dërguar presidentit të Konfederatës Evropiane të Boksit, Humbert Furgoni-t dhe drejtorit ekzekutiv të AIBA-s, Ho Kim-it.

Në këtë drejtim, drejtuesve të FboxK-së u kishte dalë në ndihmë edhe Luan Krasniqi. Boksieri junikas kishte angazhuar avokatin e tij personal që t'u ndihmonin krerëve të FboxK-së që ta arinin qëllimin – pranimin në AIBA. Në anën tjetër, Federata e Boksit të Kosovës, ditë më parë, ka parashtruar kërkesë për pranimin e klubeve nga Kosova në ligën amatore të boksit evropian (EuroLiga).

Deri më tani, boksierët kanë marrë pjesë vetëm nëpër turne të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku sukseset nuk kanë munguar.

Edhe Federata e Xhudos, si dhe ajo e Karatesë, presin që viti 2009 të jetë

viti i pranimin të këtyre Federatave në Asociacionet Ndërkombëtare të sportit, në mënyrë që xhudistët dhe karateistët tanë t'i masin forcat me kundërshtarë evropianë dhe botërorë.












Pranimi nuk do të thotë fundi i telasheve

Federata e Triatlonit, Bjeshkatarisë, Mundjes, dhe Pingpongut, të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht, shpresojnë që në vitin 2009 të mos kenë pengesa në pjesëmarrje nëpër kampionate dhe të gëzojnë mbështetje financiare nga shteti dhe donatorët privatë. Sigurimi i mjeteve për të dalë jashtë vendit ishte preokupim i secilës federatë. Ka ndodhur që edhe kur i siguronin mjetet nga ndonjë donator, u dilte një problem tjetër, sigurimi i vizave, për të cilat duhej të pritej me javë dhe shpeshherë u refuzohej!

Duhet cekur se Përfaqësuesja e Kosovës në Pingpong, i siguroi mjetet dhe vizat për pjesëmarrje në Kampionatin Evropian të zhvilluar në Shën-Petersburg të Rusisë, por garat i zhvilluan me pajisje (raketa + fanella) të huazuara nga përfaqësueset e huaja. Nga organizatorët thuhej se pingpongistëve të Kosovës u kishin humbur pajisjet gjatë rrugës, për t'u gjetur 5 ditë, pasi ishin zhvilluar ndeshjet!

Sportistët e Kosovës shpresojnë që në vitin 2009 t'u hapen rrugët e pjesëmarrjes në gara ndërkombëtare për ta dëshmuar veten e tyre. ■



Autor : Gazmend Morina - BENI	FOTO	KËSTI BANKAR	BABAI	KAFSHË QË MBAHET NË SHTËPI PËR NGARKESE	VENDI KU LIDHEN ESHTRAT (pashq.)	FAMË, ZULMË		THIKË E MPREHUR NGA TË DYJA ANËT QË MBAHET NË KELLËF SI ARMË BREZI	PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (turq.)	TONI ANDERSON	MA JEP	ISH FUTBOLLISTI YNË CIMILI (shq.)	LLOJ PAPAGALLI	TATUAZH (bised.)
STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI							VEGËL MUZIKORE (sh.shq.)							
KËNGËTARJA BRITANIKE KERRY (Atomic Kitten)							SHKEL E SHKO, RRËMUJË PARAGRAFI							
RRITJE					NËNË (perkdh.) LEGJENDE					GURRË, BURIM (sh.shq.) DUKATI				
DY ZANORE			AZEM MAKSUTAJ EKZEMPLAR I VETËM			SËPATA E VOGËL SILLOGAN					AUDIO RECORDING UNLIMITED FRIKACAKE, IKACAKE			
NEVADA		PËRGËZIMI VEND LUFTIMI I GLADIA- TORËVE						PJESË E SYRIT IMITUESI						E SHOSHITUR
TRAJNERI I KOMBËTARES SHQIPTARE NË FUTBOLL ARI ...				KËNGËTARJA AMERIKANE BRAXTON BASHKËT- INGËLLORE					SHKOVA, ECA (bised.) ZANORE				ELBASANI LUFTETARI YNË I LUFTËS SE SPANJES VOKSHI (shq.)	
BIMË BARISH- TORE NJËV- JEÇARE E VËNDEVE TË NGROHTA ME KOKRRA TË VOGLA					OBJEKTI I BISEDËS LLOJ BUKE					BANOR I HER- SHËM I NJË KRAHINE A I NJË VENDI ENI LENOKS				
QË NUK PLOT- PJESËTOHET ME DY (mat.)				LLOJI, TIPI (krah.) AKTORI HOLLIVUDIAN CRUISE					KOMPOZITORI PRESHEVA (shq.) IKER KASILLAS					
MËRIA, ZILIA						PRJËS I HUNËVE MUZIKANTI BAJRI (shq.)						IGLI TARE		
	GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI KIMIK PARAPËLQIM						ALBIN KURTI KËNGËTARJA JONË QAZIMI			KORÇA BASHKËT- INGËLLORE		MADAKASKAR, UGANDA ZELANDA		
BASHKËT- INGËLLORE		KRIJIMI I NJË FILMI TË VIZATUAR	POPULL (turq.) LUMË NË SHQIPËRI							NËPUNËSI MË I LARTË NË PERANDORINË OSMANE (pashq.) LYERJA ME NIKEL				
KORNIZË				MJET PËR DREJTIMIN E KAMIONIT										
PJATA				ARKA SHTETËRORE (lat.) MORI, HEJ										
NGADHNJE (bised.)					ZANORE I PARI I XHAMISË (pashq.)		ILAZ KODRA BESIM, FE (mysl.)							
EDVIN MURATI			KËNGËTARI I FAMSHËM NGA PORTO-RIKO MARTIN NATRIUM, URANIUM							ZANORE NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE				
BËRJE MË I RI						PJESË E LIMANIT KU QËNDROJNË ANIJET NORA ISTREFI								
GRIMCOVA (krah.)				EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN (shq.)										
BREJTËS I VOGËL (shq.)				VËNIE E MINAVE										

